

VENDIM
Nr. 787, datë 24.12.2025

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR KONTROLLIN E
ARMËVE TË VOGLA, TË LEHTA, MUNICIONEVE DHE EKSPLIZIVËVE 2025–
2030 DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT 2025–2028**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2025–2030 dhe të planit të veprimit 2025–2028, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, ministritë dhe institucionet përgjegjëse të përmendura në strategji dhe në planin e veprimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

STRATEGJIA KOMBËTARE
PËR KONTROLLIN E ARMËVE TË VOGLA, TË LEHTA, MUNICIONEVE DHE
EKSPLIZIVËVE 2025–2030
DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2025–2028, NË ZBATIM TË SAJ

Lista e shkurtesave:

MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MF	Ministria e Financave
MD	Ministria e Drejtësisë
MA	Ministria e Arsimit
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MM	Ministria e Mbrojtjes
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
MTKS	Ministria e Turizmit Kulturës dhe Sportit
MSHPV	Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
PSH	Policia e Shtetit
AS	Akademia e Sigurisë
SPAK	Struktura e Posaçme Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
PP	Prokuroria e Përgjithshme
GJKKO	Gjykata e Posaçme Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KLGI	Këshilli i Lartë Gjyqësor
SHM	Shkolla e Magjistraturës
ILD	Inspektorati i Lartë i Drejtësisë
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
PPAP	Planifikimi i Projekt-Akteve Prioritare
AKSHE	Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve
ASHPSKN	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës
SHISH	Shërbimi Informativ i Shtetit
BE	Bashkimi Evropian
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
OSBE	Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë
KiE	Këshilli i Evropës
AVL	Armët e Vogla dhe të Lehta
AME	Armët, Municionet dhe Eksplozivët
AVLME	Armët e Vogla dhe të Lehta, Municionet dhe Eksplozivët
IPSIS	Sistemi Informativ i Sistemit të Planifikimit të Integruar
SELEC	Qendra e Zbatimit të Ligjit e Evropës Juglindore
SEESAC	Zyra Qendrore e Evropës Lindore dhe Juglindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta
SEEFEN	Rrjeti i Evropës Juglindore i Ekspertëve të Armëve të Zjarrit
SEEFEG	Grupi i Evropës Juglindore i Ekspertëve të Armëve të Zjarrit
NJQAZ	Njësia Qendrore për Armët e Zjarrit

PËRMBAJTJA

PJESA I. KONTEKSTI STRATEGJIK

1. Hyrja dhe qëllimi
2. Kuadri ligjor, institucional, arritjet
3. Vizioni i Strategjisë

PJESA II. QËLLIMI I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË STRATEGJISË

PJESA III. PROJEKTET NË MBËSHTETJE TË ZBATIMIT TË STRATEGJISË

PJESA IV. ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

- 4.1 Përgjegjësia e institucioneve
- 4.2 Monitorimi dhe raportimi

PJESA V. BUXHETI

PJESA I KONTEKSTI STRATEGJIK

1. Hyrja dhe qëllimi

Lufta kundër krimit të organizuar dhe garantimi i rendit dhe sigurisë publike përbëjnë prioritetet strategjike të Qeverisë së Shqipërisë. Prania e armëve të zjarrit dhe municioneve pa leje në duart e qytetarëve përbën një kërcënim serioz për jetën njerëzore dhe rendin publik, duke ndikuar negativisht në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit. Pavarësisht tendencave rënëse në disa tregues, trafikimi dhe përdorimi i paligjshëm i armëve, eksplozivëve dhe prekursorëve të tyre vazhdon të jetë një sfidë madhore për rendin dhe sigurinë publike. Ministria e Punëve të Brendshme me strukturat e saj përgjegjëse, duke e trajtuar këtë çështje si një rrezik me ndikim në sigurinë kombëtare dhe në kontekstin e luftës kundër terrorizmit, i ka kushtuar

vëmendje të veçantë parandalimit dhe goditjes së veprimtarive kriminale që lidhen me armët, duke angazhuar burime dhe kapacitete të posaçme në funksion të menaxhimit efektiv dhe kontrollit të këtij fenomeni.

Prioriteti kryesor mbetet krijimi i një ambienti të sigurt për qytetarët, bizneset dhe shoqërinë në tërësi. Për këtë qëllim, strategjia e re kombëtare për kontrollin e armëve të vogla e të lehta, municioneve dhe eksplozivëve dhe plani i saj i veprimit u hartua në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030, Programin e Qeverisë 2021–2025, në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit, si dhe me Programin Kombëtar të Integritimit Evropian dhe *acquis*-it të Bashkimit Evropian përkatësisht në kapitullin 1 “Tregtia e lirë e mallrave”, 24 “Drejtësia, Liria dhe Siguria” dhe 31 “Politika e jashtme, e sigurisë dhe mbrojtjes”. Kjo strategji e re, gjithashtu, do të sigurojë dhe monitorojë përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë sipas marrëveshjeve dhe dokumenteve ndërkombëtare në fushën e kontrollit të armëve, duke përfshirë Programin e Veprimit dhe Instrumentit Ndërkombëtar të Gjurmimit të Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Çështjen e Çarmatimit, Dokumentin për Armët e Vogla dhe të Lehta e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Traktatin e Tregtisë së Armëve, Protokollin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara kundër Prodhimit të Paligjshëm dhe Trafikimit të Armëve të Vogla dhe të Lehta, Kodin e Sjelljes të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë mbi Aspektet Politiko-Ushtarake të Sigurisë. **Strategjia kombëtare për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta, municioneve dhe eksplozivëve dhe plani i saj i veprimit do të harmonizohet gjithashtu me Rezolutën nr. 1325, të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara “Mbi gruan, paqen dhe sigurinë” dhe me Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave.**

Gjithashtu, këto masa do të sigurojnë përputhjen me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të OKB-së dhe të Udhërrëfyesit për një zgjidhje të qëndrueshme ndaj posedimit të paligjshëm, keqpërdorimit dhe trafikimit të armëve të vogla dhe të lehta, municioneve dhe eksplozivëve në Ballkanin Perëndimor deri në vitin 2030, duke rritur kontrollin, transparencën dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në funksion të forcimit të sigurisë kombëtare dhe globale.

Republika e Shqipërisë nëpërmjet miratimit të strategjisë së re në fushën e kontrollit të armëve të vogla e të lehta, municioneve dhe eksplozivëve për periudhën 2025–2030 synon të forcojë kontrollin dhe menaxhimin e armëve të vogla dhe të lehta përmes një qasje të strukturuar dhe të harmonizuar me standardet e BE-së dhe detyrimet ndërkombëtare. Objektivat kryesorë përfshijnë miratimin dhe zbatimin e një legjislacioni të plotë e të përditësuar, bazimin e politikave në analiza dhe statistika, si dhe uljen e ndjeshme të qarkullimit të paligjshëm të armëve, municioneve dhe eksplozivëve. Strukturat përgjegjëse do të vijnë në ndërmarrin masa për reduktimin e ofertës dhe kërkesës për armë, shkatërrimin sistematik të stoqeve të tepërta të armatimit dhe forcimin e mekanizmave për parandalimin e trafikimit dhe devijimit të armëve drejt tregut të zi. Këto përpjekje synojnë të rrisin sigurinë kombëtare dhe rajonale, duke kontribuar njëkohësisht në stabilitetin dhe sigurinë kombëtare dhe anëtarësimin të vendit në Bashkimin Evropian.

Qëllimi kryesor i kësaj strategjie gjashtëvjeçare është kontrolli i plotë mbi armët e vogla dhe të lehta, municionet dhe eksplozivët, duke u bazuar në nevojat dhe objektivat e vendit në këtë fushë si dhe standardet e BE-së, OKB-së dhe OSBE-së. Ky dokument strategjik ka për qëllim të caktojë orientime të përgjithshme për institucionet dhe agjencitë, të cilat zbatojnë aktivitete në kuadër të fushës së kontrollit të armëve të vogla e të lehta, municioneve dhe eksplozivëve, për vitet e ardhshme. Dokumenti paraqet njëkohësisht edhe vizionin e Qeverisë së Shqipërisë për kontrollin e armëve, municionit dhe eksplozivëve dhe angazhimet ndërinstitucionale të materializuara në planin përkatës të veprimit. Zbatimi i strategjisë dhe planit të veprimit lidhet ngushtë edhe me bashkëpunimin ndërinstitucional gjithëpërfshirës dhe atë ndërkombëtar në fushën e kontrollit dhe luftës kundër trafikimit të paligjshëm.

Strategjia e re do të vazhdojë të shërbejë si një dokument konsensual, i zhvilluar për të arritur një zgjidhje të qëndrueshme ndaj posedimit të paligjshëm, keqpërdorimit dhe trafikimit të armëve, municioneve dhe eksplozivëve në Shqipëri. Ky dokument përfaqëson një angazhim të qartë institucional për të adresuar sfidat aktuale në fushën e sigurisë dhe për të përmbushur objektivat e vendosur brenda një afati të përcaktuar, ku ofron një kuadër të përbashkët veprimi për performancën e pritshme dhe përcakton nivelin e angazhimit të kërkuar në planin strategjik, politik dhe operacional, në përputhje me detyrimet që burojnë nga dokumente kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

2. Kuadri ligjor, institucional, arritjet

2.1 Kuadri ligjor

Në fushën e kontrollit të AVLME, Republika e Shqipërisë ka në zbatim një bazë të gjerë ligjore, si:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;
- Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale të RSH-së”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
- Ligji nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”;
- Ligji nr. 87/2024, “Për rregullimin e prodhimit, tregtimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve”, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”;
- Ligji nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 39/2025, “Për kontrollin e Kufirit Shtetëror”;
- Ligji nr. 74/2014, “Për armët”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 61/2016, “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 60/2022, “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 6/2014, “Për ratifikimin e “Traktatit për tregtimin e armëve të vogla”;
- Ligji nr. 46/2018, datë 23.7.2018, “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”;
- Ligji nr. 74/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil”;
- Ligji nr. 73/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”;
- Ligji nr. 75/2014, “Për Shërbimin privat të sigurisë fizike”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 72/2014, “Për përdorimin e armëve të zjarrit”;
- Ligji 8/2020, “Për policinë e burgjeve”, i ndryshuar;
- VKM-ja nr. 405, datë 1.6.2016, “Për miratimin e procedurave të armëmbajtjes në vendet e punës”;
- VKM-ja nr. 31, datë 22.1.2020, “Për organizimin, përbërjen, funksionimin dhe statusin e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, përcaktimin e afateve, të mënyrës dhe të procedurës për shkëmbimin e informacionit dhe të marrjes së mendimit nga institucionet e tjera të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara, si dhe përcaktimin e procedurave për lëshimin e garancive dhe kryerjen e kontrollit shtetëror”;
- VKM-ja nr. 511, datë 1.8.2024, “Për miratimin e listës së mallrave ushtarake dhe listës së artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”;
- VKM-ja nr. 604, datë 10.8.2016, “Për kriteret e caktimit të vendeve për qitje dhe stërvitje me armë zjarri dhe përdorimin e tyre”;
- VKM-ja nr. 640, datë 7.9.2016, “Për përcaktimin e procedurave të certifikimit të instruktorëve dhe instruktorëve trajnerë të armëve të zjarrit”;
- VKM-ja nr. 643, datë 7.9.2016, “Për përcaktimin e kërkesave dhe procedurave të pajisjes me leje për veprimtaritë me armë zjarri dhe municion”;
- VKM-ja nr. 645, datë 7.9.2016, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për transportimin e armëve dhe municioneve”;

- VKM-ja nr. 648, datë 7.9.2016, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për dhënien e lejeve për mbajtjen e armëve në banesë”;
- VKM-ja nr. 649, datë 7.9.2016, “Për përcaktimin e kriterëve për dhënien e lejeve të posedimit të armëve për qëllime sportive dhe të gjuetisë”;
- VKM-ja nr. 650, datë 7.9.2016, “Për përcaktimin e mënyrës së marrjes, të ruajtjes dhe të administrimit të armëve dhe municioneve të sekuestruara ose të konfiskuara”;
- VKM-ja nr. 651, datë 7.9.2016, “Për përcaktimin e kriterëve të mbajtjes, transportimit, tregtimit dhe kontrollit të armëve për forcat e armatosura dhe institucionet e tjera shtetërore”;
- VKM-ja nr. 652, datë 7.9.2016, “Për përcaktimin e kushteve për personelin e shoqërive të sigurisë private që pajisen me armë zjarri dhe municion”;
- VKM-ja nr. 653, datë 7.9.2016, “Për përcaktimin e kushteve të marrjes dhe të përdorimit të armëve të zjarrit për punonjësit e policisë”;
- VKM-ja nr. 654, datë 7.9.2016, “Për miratimin e listës së armëve dhe municioneve që nuk lejohet të mbahen nga personat fizikë dhe juridikë”;
- VKM-ja nr. 656, datë 7.9.2016, “Për përcaktimin e llojeve dhe të sasive të lejuara të armëve dhe municioneve që mund të mbahen nga personat fizikë dhe juridikë”;
- VKM-ja nr. 672, datë 22.11.2017, “Për përcaktimin e rregullave për regjistrimin, sistemimin dhe ruajtjen e dokumentacionit për lejet e armëve dhe veprimtarive me armë”;
- VKM-ja nr. 511, datë 1.8.2024, “Për miratimin e listës së mallrave ushtarake dhe listës së artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë, objekt i kontrollit shtetëror të transferimeve ndërkombëtare”;
- VKM-ja nr. 674, datë 5.10.2018, “Për përcaktimin e kushteve për pajisjen me armë të punonjësve të institucioneve që ushtrojnë veprimtari me karakter shtetëror”;
- VKM-ja nr. 739, datë 12.12.2018, “Për krijimin, përbërjen dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar të Kontrollit të Armëve të Vogla dhe të Lehta”;
- VKM-ja nr. 411, datë 19.6.2019, “Për rregullat e përcaktimit të vendeve dhe kriterëve për qitje”;
- VKM-ja nr. 799, datë 4.12.2019, “Për miratimin e rregullores për verifikimin e përshtatshmërisë së armëve dhe klasifikimin sipas qëllimit të përdorimit”;
- VKM-ja nr. 410, datë 24.6.2020, “Për përcaktimin e masave teknike dhe rregullave për përdorimin e sistemit elektronik të lejeve për armë zjarri”;
- VKM-ja nr. 644, datë 7.10.2020, “Për përcaktimin e rregullave të sigurisë për ruajtjen e armëve dhe municioneve në banesa dhe objekte të sigurisë”;
- VKM-ja nr. 161, datë 10.3.2021, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për verifikimin mjekësor dhe psikologjik të aplikantëve për armë zjarri”;
- VKM-ja nr. 776, datë 15.12.2021, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të krijimit të sistemit të gjurmimit të artikujve piroteknikë”;
- VKM-ja nr. 533, datë 14.9.2022, “Për përcaktimin e procedurave të dhënies së autorizimeve për tregtimin dhe transportimin e artikujve piroteknikë”;
- VKM-ja nr. 951, datë 9.11.2022, “Për miratimin e rregullores për kontrollin e përdorimit të artikujve piroteknikë dhe lëndëve plasëse”;
- VKM-ja nr. 509, datë 30.8.2023, “Për përcaktimin e kushteve të posaçme të licencimit dhe autorizimit, dokumenteve shoqëruese, që paraqiten për pajisjen me licencë apo autorizim, afatit të vlefshmërisë së licencës dhe autorizimit, procedurave të shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe afateve për kryerjen e tyre, si dhe procedurave të shfuqizimit/pezullimit të licencave e autorizimeve për prodhimin, importimin, eksportimin, transitimin e artikujve piroteknikë”;
- VKM-ja nr. 646, datë 22.11.2023, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për krijimin e sistemit të gjurmimit dhe identifikimit të lëndëve plasëse për përdorim civil”;

- VKM-ja nr. 247, datë 30.4.2025, “Për procedurat, kushtet, kriteret, afatet, vlefshmërinë dhe formatet për dhënien, shfuqizimin dhe pezullimin e licencave dhe autorizimeve për prodhim, importim, eksportim, transmetimin e lëndëve plasëse për përdorim civil”;

- VKM-ja nr. 248, datë 30.4.2025, “Për përcaktimin e llojeve të licencave/certifikatave dhe autorizimeve të dokumentacionit të aplikimit, formateve të kërkesave të aplikimeve, si dhe formateve të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për transferimet ndërkombëtare për mallrat ushtarake dhe artikujt e teknologjisë me përdorim të dyfishtë, që lëshohen nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve”;

- Udhëzimi i përbashkët nr. 88, datë 10.3.2015, i ministrit të Punëve të Brendshme dhe i ministrit të Shëndetësisë, “Për llojet e vizitave dhe përmbajtja e raportit mjekësor për veprimtaritë me armët”;

- Udhëzimi i përbashkët nr. 90, datë 10.3.2015, i Ministrisë së Punëve të Brendshme, ministrit të Mbrojtjes dhe Prokurorit të Përgjithshëm, “Për procedurat dhe rregullat e hollësishme të trajnimit të armëve provë materiale”;

- Udhëzimi nr. 262, datë 25.5.2015, i Ministrisë së Punëve të Brendshme “Për procedurat për lëshimin/revokimin e dëshmisë për aftësimin teorik e praktik për armët, formati i saj, si dhe procedurat e certifikatës për drejtues teknik për veprimtaritë e lejuara me armët për programin e kursit të trajnimit për aftësimin teorik dhe praktik për armët dhe kushtet e objektit ku zhvillohet ky program”;

- Udhëzimi nr. 277, datë 29.5.2015, “Për procedurat, dokumentacionin dhe afatet e shqyrtimit për pajisjen me autorizim për armë të subjekteve juridikë e fizikë, formatin e regjistrimit për armët për subjektin e licencuar për veprimtaritë me armët, për rregullat, procedurat dhe formularin që plotësohet në kohën e realizimit të qitjes eksperimentale dhe administrimin e gëzhgjës në një bankë të dhënash”, të ndryshuar;

- Udhëzimi i përbashkët nr. 264/1, datë 29.6.2015, i ministrit të Punëve të Brendshme dhe i ministrit të Financave “Për masën, kriteret dhe procedurat për tarifën financiare për veprimtarinë e lejuar me armët”;

- Udhëzimi i ministrit të Brendshëm nr. 198, datë 18.11.2024, “Procedurat për pajisjen me autorizim për veprimtarinë e lejuar me armë, regjistrimin e armës, administrimin e gëzhgjës në një bankë të dhënash dhe procedurat që kryhen pas dorëzimit në policinë shkencore”;

- Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe i Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë nr. 221, datë 8.11.2024, “Për masën, kriteret dhe procedurat për tarifën financiare për veprimtarinë e lejuar me armët”;

- Urdhri i ministrit të Brendshëm nr. 666, datë 18.12.2018, “Për organizimin e punës për analizën e *acquis* të Bashkimit Evropian, në kuadër të procesit ‘Screening’ për kapitullin 24 ‘Drejtësia, Liria dhe Siguria’”, i ndryshuar me urdhrin e ministrit nr. 145, datë 31.1.2019 “Mbi disa ndryshime në urdhrin nr. 666, datë 18.12.2018, ‘Mbi organizimin e punës për analizën screening’”, pasuar nga një analizë e plotë e përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së për armët;

- Udhëzimi i ministrit të Brendshëm nr. 386, datë 23.11.2021, “Për procedurat, dokumentacionin dhe afatet e shqyrtimit për pajisjen me autorizim për armë të subjekteve juridikë dhe fizikë, formatin e regjistrimit për armët dhe municionet për subjektin e licencuar për veprimtaritë me armët, për rregullat, procedurat dhe formularin që plotësohet në kohën e realizimit të qitjes eksperimentale dhe administrimin e gëzhgjës në një bankë të dhënash”;

- Udhëzimi i ministrit të Brendshëm nr. 334, datë 28.10.2021, “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e ministrit të Brendshëm nr. 262, datë 25.5.2015, ‘Për procedurat për lëshimin/revokimin e dëshmisë për aftësimin teorik e praktik për armët, formati i saj, si dhe procedurat e certifikatës për drejtues teknik, për veprimtaritë e lejuara me armët, formati i saj, si dhe procedurat e certifikatës për drejtues teknik, për veprimtaritë e lejuara me armët, për

programin e kursit të trajnimit, për aftësimin teorik dhe praktik për armët dhe kushtet e objektit ku zhvillohet ky program”;

- Urdhri i Kryeministrit nr. 69, datë 22.5.2017, “Për ngritjen e Komisionit Kombëtar për Armët e Vogla dhe të Lehta;

- Urdhri i ministrit të Brendshëm nr. 203, datë 18.11.2024, “Për ngritjen e komisioneve për veprimtarinë e lejuar me armët”;

- Urdhri i ministrit të Brendshëm nr. 199, datë 18.11.2024, “Për ngritjen e komisioneve për dhënien e autorizimit për magazinim, transferim dhe asgjësim të lëndëve plasëse”;

- Urdhri i ministrit të Mbrojtjes nr. 906, datë 20.6.2024, “Për miratimin e rregullores ‘Për masat e sigurisë që duhet të marrin operatorët ekonomikë të përfshirë në veprimtarinë e prodhimit, eksportit, transitit të artikujve piroteknike”;

- Urdhri nr. 417, datë 2.5.2018, i drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, “Për formën dhe përmbajtjen e vërtetimit të besueshmërisë”;

- Urdhri i drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 115, datë 25.1.2019, “Për organizimin e punës në procesin e përafrimit të legjislacionit, në kuadër të procesit të integritetit evropian”;

- Urdhri i drejtorit të përgjithshëm të Burgjeve nr. 5230/1, datë 24.8.2009, “Për miratimin e normave të plotësimit me armatime e municione për punonjësit e Policisë së Burgjeve”;

- Urdhri i drejtorit të përgjithshëm të Burgjeve nr. 6596/1, datë 24.8.2009, “Për miratimin e mjeteve dhe pajisjeve në përdorim të policisë së burgjeve”;

- Urdhri i drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, “Për miratimin e procedurave të certifikimit dhe formatit të certifikatës së drejtuesit teknik për veprimtarinë e lejuar me armë”;

- Urdhri i drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1214, datë 6.12.2021, “Procedura standarde e veprimit në rastet e zbulimit të armëve/municioneve/lëndëve plasëse që paraqesin rreziqe të konsiderueshme ndaj sigurisë dhe mbrojtjes”;

- Urdhri i drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 923, datë 23.6.2025 “Rastet, modalitetet dhe strukturat që hartojnë vërtetimin e besueshmërisë”;

- Udhëzimi i ministrit të Brendshëm nr. 334, datë 28.10.2021, “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e ministrit të Brendshëm nr. 262, datë 25.5.2015, ‘Për procedurat për lëshimin/revokimin e dëshmisë për aftësimin teorik e praktik për armët, formati i saj, si dhe procedurat e certifikatës për drejtues teknik, për veprimtarinë e lejuara me armët, për programin e kursit të trajnimit, për aftësimin teorik dhe praktik për armët dhe kushtet e objektit ku zhvillohet ky program”;

- Urdhri nr. 367 datë 18.11.2021, “Për përbërjen, detyrat dhe mënyrën e funksionimit të Komisionit për pajisjen e subjekteve me licencë/autorizim për veprimtarinë e lejuar me armë”.

2.2 Arritjet

Në kuadër të zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta 2019–2024 janë arritur rezultatet të konkrete, ndër të cilat:

- Ngritja e **Komisionit Kombëtar për Armët e Vogla dhe të Lehta**, i cili është përmendur edhe në raportet e progresit të Komisionit Evropian gjatë viteve të fundit. Komisioni Kombëtar për Armët e Vogla dhe të Lehta (AVL) është organizëm ndërminstor përgjegjës për planifikimin, koordinimin, monitorimin dhe raportimin e të gjitha aktiviteteve të lidhura me kontrollin e armëve në Republikën e Shqipërisë, me qëllim për të siguruar një mjedis të sigurt dhe për të krijuar në këtë mënyrë kushte të favorshme për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Ky komision është një organ kyç në sigurimin e kontrollit dhe rregullimit të posedimit, përdorimit dhe trafikimit të armëve të vogla dhe të lehta. **Funksioni kryesor i tij** është monitorimi dhe zbatimi i politikave kombëtare dhe ndërkombëtare në këtë fushë, përmes bashkëpunimit ndërinstitucional dhe me partnerët ndërkombëtarë.

Komisioni Kombëtar i Armëve të Vogla e të Lehta Komisioni si mekanizëm ndërinstytucional është ngritur me urdhër të Kryeministrit nr. 69, datë 22.5.2017, “Për ngritjen e Komisionit Kombëtar për Armët e Vogla dhe të Lehta”.

Ky Komision kryesohet nga zëvendësministri i Brendshëm dhe ka në përbërje të tij përfaqësues në nivel drejtor drejtorie nga ministritë e linjës, emërtimet e të cilave kanë pësuar ndryshime gjatë viteve të ushtrimit të veprimtarisë së këtij Komisioni, por përfshijnë përfaqësues nga ministritë përgjegjëse për punët e brendshme; për Evropën dhe punët e jashtme; mbrojtjen; drejtësinë, financat, shëndetësinë dhe mirëqenien sociale, turizmin, mjedisin, ekonominë dhe inovacionin, arsimin, si dhe nga agjencitë ligjzbatuese, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE).

Komisioni mbledhet të paktën dy herë vit dhe ka përgjegjësi:

- për koordinimin e hartimit të politikave mbi armët e vogla dhe të lehta në Shqipëri;
- për koordinimin dhe mbledhjen e informacioneve dhe statistikave nga institucionet përkatëse për prodhimin, tregtimin, çaktivizimin, asgjësimin, përdorimin e paligjshëm të armëve, kontrollin e armëve të lejuar, kontrollin e importit dhe eksportit të armëve;

- për ndjekjen e përmbushjes së detyrimeve ndërkombëtare në këtë fushë dhe koordinimin e ndihmës/asistencës së huaj (organizata dhe partnerë ndërkombëtarë).

- Krijimi i **Njesisë Qendrore të Armëve të Zjarrit** si një strukturë në kuadër të Departamentit të Policisë Kriminale në Policinë e Shtetit përfaqëson një mekanizëm të specializuar për forcimin e kapaciteteve institucionale në kontrollin, parandalimin dhe luftën kundër veprimtarive të paligjshme që lidhen me armët, municionet dhe materialet shpërthyes. Kjo njësi ka detyra të përcaktuara qartë për koordinimin e hetimeve, mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, gjurmimin balistik dhe kriminalistik të armëve, si dhe bashkëpunimin me strukturat kombëtare dhe ndërkombëtare për shkëmbimin e informacionit dhe zbatimin e standardeve të përbashkëta. Njësia shërben gjithashtu si pikë kombëtare kontakti për bashkëpunim ndërkufitar dhe ndërinstytucional, duke kontribuar drejtpërdrejtë në përmbushjen e objektivave strategjike të sigurisë dhe detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të procesit të integritetit evropian dhe marrëveshjeve ndërkombëtare për kontrollin e armëve të zjarrit. Ngritja e NJQAZ-së shënon edhe përmbushjen e një prej rekomandimeve kryesore të Komisionit Evropian në këtë fushë për krijimin e NJQAZ-së si një strukture të përhershme, sipas modelit dhe standardeve të Pikave Fokale të Armëve të Zjarrit në vendeve të Bashkimit Evropian.

- Arritja e disa nga objektivave kyç të planit të veprimit për kontrollin e armëve, duke miratuar një kuadër ligjor të përditësuar dhe të harmonizuar me rregulloret e **Bashkimit Evropian** dhe detyrimet ndërkombëtare. Ky përmirësim legjislativ krijoi bazën për politika më efektive dhe standardizim me vendet e të rajonit, duke forcuar bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar. Konkretisht, në vitin 2020, Shqipëria rishikoi kuadrin ligjor në fushën e armëve duke miratuar ndryshimet në ligjin 74/2014, “Për armët”, e cila pasoi me miratimin e dy ligjeve të rëndësishme për lëndët plasëse dhe artikujt piroteknikë, përkatësisht ligji 74/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil” dhe ligji 73/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”, si edhe rregulloren për çaktivizimin e armëve të zjarrit të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 348, datë 26.5.2022, “Rregullorja, standardet dhe teknikat e çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre”, ku të gjitha këto akte përafruan legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian për fushën përkatëse.

- Progresi i objektivave për realizim deri në vitin 2024 ka qenë i dukshëm, veçanërisht në bazimin e politikave të kontrollit të armëve mbi statistika dhe të dhëna të inteligjencës. Përmirësimi i mekanizmave të mbledhjes dhe analizimit të informacionit ka mundësuar një qasje më të strukturuar në luftën kundër trafikimit të paligjshëm të armëve, duke reduktuar në mënyrë të konsiderueshme qarkullimin e tyre brenda dhe jashtë **Republikës së Shqipërisë**.

- Ngritja dhe funksionimi i Sistemit të Menaxhimit Policor të Çështjes, një platformë e integruar për shkëmbimin e informacionit në fushën e drejtësisë penale, me synim përfshirjen e Policisë së Shtetit, Prokurorisë dhe Gjykatave, i cili aktualisht përdoret dhe përditësohet nga Policia e Shtetit, ndërsa janë ndërmarrë hapa konkretë për zgjerimin e aksesit dhe funksionalitetit të tij edhe për institucionet e tjera të drejtësisë. Kjo përbën një hap të rëndësishëm drejt krijimit të një sistemi të unifikuar dhe efikas për shkëmbimin e të dhënave, përfshirë ato që lidhen me rastet e ndjekura penalisht dhe të gjykuara që përfshijnë përdorimin e armëve të zjarrit.

- Në kuadër të uljes së sasisë së tepërt dhe asgjësimi i armëve të vogla e të lehta dhe municioneve të tyre të kapura, në zbatim të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, i rishikuar, si dhe të Strategjisë për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2019–2024, gjatë periudhës 2022–2024 është realizuar shkatërrimi i sasive të konsiderueshme të AVL-ve dhe pjesëve përbërëse të armëve, në përputhje me standardet e sigurisë. Konkretisht, në vitin 2022 u asgjësuan 5509 copë AVL, ndërsa në vitin 2023 u shkatërruan 1017 copë AVL dhe rreth 411363 copë pjesë përbërëse të armëve, proces që u krye në Uzinën Mekanike Gramsh. Këto rezultate dëshmojnë përkushtimin e institucioneve përgjegjëse për të reduktuar rreziqet dhe për të siguruar menaxhimin e përgjegjshëm të armatimit dhe municioneve.

- Në lidhje me luftën dhe kontrollin e armëve të vogla e të lehta, një numër i konsiderueshëm armësh të paligjshme dhe municione janë sekuestruar gjatë viteve të fundit. Referuar rasteve të konstatuara të mbajtjes dhe prodhimit të armëve pa leje gjatë periudhës 2019–shtator 2024 ka pasur një nivel zbulueshmërie të armëmbajtjes pa leje prej 78.6% nga strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit. Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur raste të evidentuara të prodhimit të armëve në mënyrë të kundërligjshme, punishte apo vende të përshtatura për këtë aktivitet. Në lidhje me prodhimin dhe mbajtjen pa leje të armëve të gjuetisë dhe sportive gjatë periudhës 2019–2024 ka pasur një zbulueshmëri prej 99.1% nga strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit. Në lidhje me trafikimin e armëve dhe municioneve gjatë periudhës 2019–2024 ka pasur një zbulueshmëri prej 91.7% nga strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit. Në bazë të numrit të sekuestrimeve gjatë periudhës 2019–2024 evidentuan një total prej 3180 armësh të sekuestruara, ku përmendim pistoletat 1574 copë (rreth 49.5 % të totalit), të ndjekura nga armët e gjahut 727 copë (rreth 22.86% të totalit) dhe automatiket kallashnikov me 879 (rreth 27.64 % të totalit).

- Forcimi i kapaciteteve hetimore dhe rritjes së efikasitetit në identifikimin e provave materiale balistike, nëpërmjet instalimit me financim të Qeverisë Franceze të sistemit modern EVOFINDER në Sektorin e Ekzaminimeve Balistike pranë Institutit të Policisë Shkencore. Ky sistem, i cili zëvendëson teknologjinë e mëparshme ARSENAL ofron imazh të avancuar 3D, laser skaner me cilësi të lartë, kapacitet më të madh dhe shpejtësi më të lartë përpunimi. Instalimi i tij krijon mundësinë për të shkëmbim të dhënash balistike me vendet e tjera të rajonit dhe më gjerë, duke përfshirë Francën, Greqinë dhe Gjermaninë. Pas trajnimit të stafit, në një kohë të shpejtë u krye regjistrimi i të dhënave për ngjarjet e ndodhura ndër vite (2009–2025), duke përmbushur standardet ndërkombëtare për kartotekën balistike. Që prej përdorimit të tij, sistemi ka rezultuar plotësisht efikas në identifikimin e armëve, gëzhgojave dhe predhave, përfshirë edhe rastet e mikro-relievit, duke e kthyer instalimin e EVOFINDER në një histori suksesi dhe një arritje të rëndësishme nga pikëpamja e zhvillimit të kapaciteteve teknologjike në fushën e balistikës.

- Zhvillimi i kontrolleve periodike në subjektet që tregtojnë armët e zjarrit si për kushtet e mbajtjes, transportit dhe ruajtjes/sigurisë së tyre, ku përgjatë periudhës 2022–2024, strukturat e Policisë së Shtetit kanë ushtruar kontrolle të rregullta mbi subjektet e licencuara dhe personat e autorizuar për armët e zjarrit, si dhe mbi subjektet që ushtrojnë veprimtari me lëndë plasëse dhe artikuj piroteknikë. Në këtë kuadër, janë kryer gjithsej 874 kontrolle ndaj subjekteve të licencuara për armë, nga të cilat janë vendosur 36 masa administrative, ndërsa ndaj subjekteve

që operojnë me lëndë plasëse dhe artikuj piroteknikë janë zhvilluar 813 kontrolle, pa evidentuar shkelje.

- Forcimi i bashkëpunimit dypalësh, rajonal dhe ndërkombëtar në luftën kundër trafikimit të armëve të zjarrit, përmes mekanizmave ekzistues dhe nxitjes së praktikave të reja të bashkëpunimit operacional dhe shkëmbimit të informacionit, përmes intensifikimit të bashkëpunimit me FRONTEX, në pikat e kalimit kufitar përmes zbatimit të Operacionit të Përbashkët JO FOA Western Balkans, si dhe ka rritur shkëmbimin e vazhdueshëm të informacionit me Europol dhe Interpol, në kuadër të hetimeve të përbashkëta dhe kontrollit të armëve të zjarrit në sistemin kombëtar SIMA.

Në kuadër të një vlerësimi të nevojave për strukturat kufitare dhe kriminale nga organizatat partnere (SEESAC, UNDP, UNODC dhe OSCE) është ofruar mbështetje gjithëpërfshirëse për rritjen e kapaciteteve të shërbimeve me qëllim zhvillimin e procedurave standarde të veprimit, blerjen e pajisjeve dhe organizimin e trajnimeve, patrullimeve të përbashkëta me vendet fqinje si Kosova etj.

Gjithashtu, gjatë periudhës 2023–2024, në kuadër të veprimeve operacionale ndërkombëtare për kontrollin dhe parandalimin e armëve, municioneve dhe eksplozivëve, janë zhvilluar operacione ndërkombëtare me pjesëmarrjen e strukturave të Policisë së Shtetit, ku përmendim Operacionin Conversus, me synim parandalimin dhe evidentimin e trafikut të armëve të zjarrit të konvertuara, si dhe sekuestrimin e sendeve të tjera të kundërligjshme gjatë ditëve të përbashkëta të veprimit në Evropën Juglindore (EMPACT). Me rëndësi të veçantë ka qenë, gjithashtu, pjesëmarrja në Operacionin JAD SEE, i cili koordinohet nga Platforma EMPACT. Ky operacion kishte si synim luftën kundër trafikimit të armëve dhe municioneve, trafikimin e narkotikëve (kokainë, heroinë, *cannabis sativa*), trafikimin e qenieve njerëzore, rrjetet kriminale me rrezikshmëri të lartë dhe kontrabandimin e migrantëve. Një ndër operacionet e tjera të zhvilluara është Operacioni ARMSTRONG. Qëllimi i këtij operacioni ishte bashkëpunimi midis Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për të zbutur rrezikun e paraqitur nga armët e zjarrit të paligjshme, pjesët e tyre përbërëse dhe municionet, të trafikuar nëpërmjet shërbimeve postare, duke bërë dokumentim dhe goditje të kësaj veprimtarie kriminale, në bashkëpunim dhe koordinim me vendet e Evropës Lindore dhe Juglindore dhe ato anëtare të BE-së. Gjithashtu, përmendim Operacionin TORO, i cili ka si objekt luftën kundër posedimit dhe trafikimit të AME në “dark web”.

Gjatë periudhës 2023–2024, në kuadër të veprimeve operacionale kombëtare për kontrollin dhe parandalimin e armëve, municioneve dhe eksplozivëve, janë zhvilluar nga strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit rreth 183 operacione kombëtare, ku përmendim: rreth 153 operacione për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal; 15 operacione për veprën penale “Trafikim i armëve dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/a i Kodit Penal; 14 operacione për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”, parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal; si dhe 1 operacion për veprën penale “Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse dhe helmuese”, parashikuar nga neni 282/a i Kodit Penal.

Gjatë periudhës 2022–2024, strukturat policore kufitare kanë vijuar bashkëpunimin e ngushtë me FRONTEX në kuadër të Operacionit të Përbashkët JO FOA Western Balkan, me fokus parandalimin e trafikimit të armëve të zjarrit në kufirin shtetëror me Greqinë. Krahas kësaj, janë forcuar ndjeshëm kapacitetet operacionale përmes një sërë donacionesh nga partnerë ndërkombëtarë. Në vitin 2022 u siguruan pajisje të specializuara për kufirin nëpërmjet mbështetjes së Republikës Federale të Gjermanisë. Në vitin 2023, me mbështetjen e IOM, Ambasadorëve Gjerman dhe Amerikan, EU4LEA, SEESAC dhe Ministrisë së Brendshme të Mbretërisë së Bashkuar, u përfituan pajisje moderne teknologjike, mjete të avancuara kontrolli, kompjuterë dhe dronë u ndërtua Qendra e Pritjes në PKK Qafë Botë, në vlerën 300 000 euro. Ndërsa në vitin 2024, në kuadër të marrëveshjes me UNDP, Policia e Shtetit përfitoi pajisje të

reja për kontrollin kufitar, përfshirë videoprojektorë, detektorë, skanerë me rreze X dhe dronë. Këto zhvillime përbëjnë një arritje të rëndësishme strategjike në forcimin e kapaciteteve të sigurisë kufitare, modernizimin e pajisjeve dhe rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar për parandalimin e trafikimit të armëve dhe krimeve ndërkufitare.

Gjatë periudhës së zbatimit të strategjisë janë përmirësuar dhe modernizuar kapacitetet logjistike dhe kapaciteteve hetuese/zbuluese duke përdorur pajisje sipas standardeve të vendeve të Bashkimit Evropian si videoskop, detektorë, skaner me rreze X dhe dronë. Në fushën e trajnimeve janë miratuar procedurat për trajnimin dhe përdorimin e qenve policorë sipas standardeve evropiane me mbështetjen e ekspertëve në kuadër të projekteve të financuara nga Republika Federale e Gjermanisë, Republika e Francës dhe BE-së, të zbatuara nga OSBE, si dhe janë kryer trajnime nga Xhandarmëria Franceze për zbulimin e armëve të vogla dhe të lehta nga qentë policorë. Më konkretisht disa nga aktivitetet e realizuara në kuadër të rritjes së kapaciteteve të qenve policorë K-9 janë hartimi i procedurave standarde të funksionimit (PSV) dhe i Master Planit për zhvillimin e kapaciteteve të qenve policorë K9, përmirësimi i kapaciteteve logjistike me automjete dhe pajisjeve për Institutin e Trajnimit të Qenve Policorë, gjithashtu kapacitetet profesionale përmes Trajnimit për Trajnerë (ToT) të punonjësve të policisë me funksion trajnues të qenve policorë për specialitetin SAMBI (frëngjisht: qen shumë-disiplinor për narkotike, monedha, arme dhe municion) në Xhandarmërinë Franceze, si edhe mundësimin të një moduli trajnimi *online* për qëndrueshmërinë dhe konsolidimin e kapaciteteve profesionale. Këto zhvillime përbëjnë një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të koordinimit ndërkombëtar dhe rritjes së efikasitetit në parandalimin dhe goditjen e krimeve që lidhen me armët e zjarrit.

- Konsolidimi i një qasje gjithëpërfshirëse për ndërgjegjësimin e popullsisë, me fokus të veçantë të gratë, burrat dhe të rinjtë, mbi rreziqet që lidhen me keqpërdorimin, mbajtjen e jashtëligjshme dhe trafikimin e armëve të vogla dhe të lehta. Nën udhëheqjen e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Shtetit, në bashkëpunim të ngushtë me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri dhe organizatat e shoqërisë civile, është zbatuar me sukses Strategjia Kombëtare e Ndërgjegjësimin dhe Komunikimit, duke përfshirë zhvillimin e fushatave të vazhdueshme ndërgjegjësuere dhe aktivitete të shënjestruara në zonat me risk të lartë të mbajtjes së armëve të jashtëligjshme. Fushatat kanë synuar ndryshimin e qëndrimeve shoqërore për armëmbajtjen, veçanërisht tek të rinjtë. Kjo arritje përfaqëson një model të suksesshëm të bashkëpunimit ndër-institucional dhe ndërsektorial në përpjekje për reduktimin e qarkullimit të armëve të paligjshme dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore, veçanërisht tek të rinjtë dhe tek gratë dhe vajzat, duke kontribuar në tërësi në rritjen e sigurisë publike në vend.

Gjatë periudhës 2023–2024 janë ndërmarrë hapa konkretë dhe të vazhdueshëm për rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve të Policisë së Shtetit në trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Gjithashtu janë zhvilluar trajnime të shumta në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë dhe organizata vendore, ku janë përfshirë mbi 480 punonjës policie në të gjitha Drejtoritë Vendore të Policisë, me fokus të veçantë në vlerësimin e riskut dhe parandalimin e keqpërdorimit të armëve të zjarrit, në këto raste. Zhvillimi i analizave periodike mbi përdorimin e armëve në ngjarjet e dhunës në familje është një ndër burimet kryesore që ka kontribuar në forcimin e politikave parandaluese.

- Në kuadër të uljes së kërcënimeve që rezultojnë nga keqpërdorimi dhe zotërimi i paligjshëm i armëve të vogla e të lehta përmes aktiviteteve ndërgjegjësuere shumëpalëshe, Ministri i Punëve të Brendshme miratoi urdhrin nr. 90, datë 1.6.2022, *“Për ngritjen e Task-Forcës për uljen e kërcënimeve që rezultojnë nga keqpërdorimi dhe zotërimi i paligjshëm i armëve të vogla e të lehta përmes aktiviteteve ndërgjegjësuere shumëpalëshe dhe të bazuara në informacion”*. Task-Forca ka kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimin për uljen e kërcënimeve që rezultojnë nga keqpërdorimi dhe zotërimi i paligjshëm i armëve të vogla e të lehta, përmes forcimit të kapaciteteve institucionale për organizimin e fushatave ndërgjegjësuere efikase

duke përfshirë aspektet e projektimit, menaxhimit, monitorimit dhe vlerësimit të fushatave ndërgjegjësuere kombëtare, si dhe duke mundësuar standardizimin e praktikave ndërgjegjësuere me vendet e Ballkanit Perëndimor.

- Në bashkërendim dhe duke u mbështetur tek arritjet e Strategjisë Kombëtare për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta dhe Eksplozivëve 2019–2024, me qëllim uljen e kërkesës dhe keqpërdorimit të armëve të vogla e të lehta në Shqipëri, Ministria e Punëve të Brendshme me Prezencën e OSBE-së hartuan Strategjinë e Ndërgjegjësimit dhe Komunikimit dhe Planin Kombëtar të aktiviteteve të ndërgjegjësimit për periudhën 2023–2027 për Armët e Vogla dhe të Lehta, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, Komisionin Kombëtar për Armët e Vogla dhe të Lehta, organizatat e shoqërisë civile, Këshillat Vendorë për Sigurinë Publike, grupet rinore, mediat, SEESAC dhe UNDP në Shqipëri. Në kuadër të zbatimit të strategjisë së miratuar janë zhvilluar fushata ndërgjegjësuere dhe aktivitete në zonat me risk të lartë nga Policia e Shtetit, me qëllim ndryshimin e qëndrimeve shoqërore ndaj armëmbajtjes, me fokus tek të rinjtë, si dhe janë ndërmarrë aktivitete për përmirësimin e raportimit etik dhe sensitiv mbi çështjet e sigurisë publike dhe armëve të vogla e të lehta, përmes zbatimit të planit të transmetimit të spoteve dhe materialeve promovuese në TV, radio dhe rrjete sociale, si dhe postimeve në media *online*.

Paralelisht janë organizuar fushata dhe aktivitete ndërgjegjësuere me të rinjtë në qytete të ndryshme të vendit, duke synuar ndryshimin e qëndrimeve ndaj rrezikut të mbajtjes dhe keqpërdorimit të armëve të vogla e të lehta dhe duke rritur ndërgjegjësimin e shoqërisë për sigurinë dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, konkretisht gjatë periudhës 2023–2024 janë zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuere, si më poshtë:

Në periudhën 2022–2024 janë ndërmarrë aktivitete për përmirësimin e raportimit etik e sensitiv mbi çështjet e sigurisë publike dhe armëve të vogla e të lehta, nëpërmjet zbatimit të planit të transmetimit të spoteve dhe materialeve promovuese në TV, radio dhe rrjete sociale, si dhe planit të përmbajtjes së postimeve në median *online*, i cili është detajuar çdo muaj. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe janë publikuar rregullisht në faqen zyrtare të Policisë së Shtetit dhe në mediat kryesore informacionet mbi incidentet dhe sekuestrimet e armëve të zjarrit.

Bazuar në Strategjinë e Ndërgjegjësimit dhe Komunikimit, me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, përgjatë vitit 2024, projekti i Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL) finalizoi me sukses implementimin e dy fushatave ndërgjegjësuere fokusuar në rritjen e ndërgjegjësimit dhe ndryshimit të qëndrimeve në lidhje me rrezikun e AVL-ve, luftimin e dhunës me bazë gjinore në lidhje me armët e vogla dhe të lehta, si dhe angazhimin e të rinjve me qëllim informimin e qytetarëve shqiptarë për rreziqet e keqpërdorimit të armëve të zjarrit dhe nxitjen e një kulture paqeje dhe sigurie.

Bazuar në hulumtimin e kryer përpara nisjes së fushatës ndërgjegjësuere u përcaktuan qytetet e targetuara, të cilat kishin numrin më të lartë të personave që posedojnë armë të jashtëligjshme, krahasuar me numrin e popullsisë si: Lezha, Shkodra, Vlora, Tirana, Durrësi, Elbasani dhe Fieri. Fushata ndërgjegjësuere me mesazhin kryesor “Ki guxim t’u thuash jo armëve” nisi në muajin maj 2024 dhe vazhdoi implementimin deri në fund të muajit dhjetor 2024, duke përfshirë fushatën digjitale përmes promovimit të spotit të fushatës, postimeve në rrjetet sociale dhe publikimin e një kënge të fushatës me angazhimin e një figure të mirënjohur të muzikës të zhanrit “rap” tek të rinjtë me sloganin “Leji armët”, si dhe duke arritur një audiencë prej 3,489,034 qytetarësh në TV, radio dhe platforma të mediave sociale.

Në kuadër të fushatës ndërgjegjësuere janë firmosur dy memorandume mirëkuptimi ndërmjet OSBE-së, Ministrisë së Punëve të Brendshme, katër Organizatave të Shoqërisë Civile dhe Bashkisë së Elbasanit, për bashkë organizimin e aktiviteteve në terren me të rinjtë dhe me kryetarët e Bashkive Elbasan, Shkodër dhe Lezhë, duke pasur si fokus kryesor temën e AVL-ve dhe në funksion të organizimit të aktiviteteve në terren me të rinjtë. Në periudhën shtator–dhjetor 2024 u zhvilluan një seri aktiviteteve ndërgjegjësuere me të rinjtë (*rreth 700 të rinj, studentë, nxënës e mësues*) me përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile në Lezhë,

Shkodër, Elbasan dhe Tiranë (Organizata Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim; Organizata Qendra e Gruas për Zhvillim dhe Kulturë; Organizata *Terre Des Hommes* dhe Organizata “Kongresi Rinor”).

Një nismë po kaq konkrete ka qenë dhe realizimi dhe prodhimi i gjashtë video dëshmime “Zëra të padëgjuar”, të konceptuara dhe regjistruara nga të rinjtë në bashkëpunim me Organizatat e Shoqërisë Civile, të publikuara në rrjetet e mediave sociale gjatë muajve nëntor–dhjetor 2024. Në po të njëjtin qëllim, në qytetet e targetuara janë vendosur e instalacioneve të quajtura “Muri i kujtesës për dhunën me armë” dhe muraleve që tejçojnë mesazhe të fuqishme për paqen, ideuar nga të rinjtë përmes artit dhe ngjarjeve të vërteta, në Bashkitë Shkodër, Elbasan dhe Tiranë.

Në *web*-faqen e Policisë së Shtetit është krijuar një dritare e veçantë në lidhje me parandalimin e përdorimit të armëve të zjarrit, me titullin “Të guximshëm pa armë”, në të cilën janë publikuar të dhëna dhe informacione në lidhje me përgjegjësinë ligjore të mbajtjes së armëve dhe keqpërdorimit të tyre, si dhe për fushatën ndërgjegjëse që po zhvillohet, link i *web*: <https://asp.gov.al/te-guximshem-pa-arme/>.

Media është informuar në mënyrë periodike për rastet ku janë përdorur armë zjarri apo në rastet e parandalimit të ngjarjeve të rënda kriminale, ku ka pasur të përfshirë armë zjarri apo lëndë plasëse.

Fushata arriti një ekspozim të gjerë mediatik, me 60.10% të të anketuarve që hasnin shpesh mesazhe të lidhura me armët e zjarrit, për të cilat u zhvillua një intervistë për Radio Televizionin Shqiptar mbi ndikimin dhe rezultatet e saj.

Impakti i fushatës ndërgjegjëse të finalizuar dhe rezultatet e sondazhit do të shërbejnë në vazhdimësi për hartimin dhe implementimin e fushatave të ardhshme ndërgjegjëse në kuadër të strategjisë së re.

Me mbështetjen e Projektit të UNDP “Forcimi i Kontrollit Administrimit dhe Qëndrimeve Sociale ndaj AVL” u zhvilluan aktivitete ndërgjegjëse në 24 shkolla të mesme në të gjithë vendin, ku u zhvilluan takimet ndërgjegjëse dhe këndet e sigurisë në shkolla.

Konkretisht janë zhvilluar takime sensibilizuese në institucione arsimore, me moton “Shkrep ide, jo armë”. Mesazhet e ndërgjegjësimit të publikut u fokusuan në:

- Rreziqet potenciale të keqpërdorimit të armëve të jetët e njerëzve, rreziqet e dhunës në familje me armë zjarri, dhe rrezikun e kryerjes së krimeve të rënda.
- Dhënien e apelit për komunitetin për të fuqizuar bashkëpunimin me policinë dhe për të ndihmuar policinë me informacione mbi qytetarët që mund të zotërojnë armë të jashtëligjshme.
- Ndëshkimin e rreptë, në përputhje me Kodin Penal, dhe pasojat sociale për individët, veçanërisht për të rinjtë, në karrierën e tyre të ardhshme personale, si dhe në jetën sociale dhe ekonomike.

Këto aktivitete kanë ndikuar në forcimin e transparencës, komunikimit publik dhe ndërgjegjësimit shoqëror për rreziqet që lidhen me armët e zjarrit.

- Forcimi i kapaciteteve institucionale të strukturave shtetërore përgjegjëse përfshirë Forcat e Armatosura, institucionet ligjzbatuese, rojën pyjore, doganat dhe shërbimet korrigjuese në drejtim të ngritjes dhe funksionalizimit të sistemeve të inspektimit dhe menaxhimit gjatë gjithë ciklit të jetës së armëve të vogla dhe të lehta dhe municioneve, në përputhje me standardet ndërkombëtare, ku janë ndërmarrë masa konkrete për sigurimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së magazinimit për armët dhe municionet, bazuar në nevojat e identifikuara dhe në përputhje me kërkesat teknike dhe standardet e sigurisë ndërkombëtare, duke synuar parandalimin e aksidenteve, shmangien e shpërdorimit dhe garantimin e sigurisë publike.

- Intensifikimi i trajnimeve, ku gjatë periudhës 2022–2024 është realizuar një program i gjerë trajnimesh për punonjësit e strukturave përgjegjëse të Policisë së Shtetit për Hetimin e Krimeve Kibernetike dhe për NJQAZ, me qëllim rritjen e kapaciteteve hetimore dhe të sigurisë kibernetike. Në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë si NCA (*National Crime Agency*),

Qeveria Japoneze, Bashkimi Evropian, Këshilli i Evropës, EU4LEA dhe SEESAC janë zhvilluar trajnime mbi hetimin e krimeve kibernetike, masat kundër krimeve kibernetike, ekipet e përbashkëta hetimore, administrimin e provave kompjuterike, patrullimin *online* dhe përdorimin e inteligjencës në burimet e hapura (OSINT). Gjithashtu, u zhvilluan trajnime të specializuara për kapacitetet analitike, mbledhjen dhe shkëmbimin e informacionit të inteligjencës, veçanërisht për veprat penale të lidhura me armët e zjarrit. Këto aktivitete kanë ndihmuar në përfundimin e aftësive profesionale, rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe përmirësimin e metodologjive të hetimit, duke u konsideruar një arritje e rëndësishme strategjike në fushën e sigurisë dhe zbatimit të ligjit.

Në tërësi, Shqipëria ka bërë hapa domethënës në përmbytjen e objektivave të saj strategjike në fushën e kontrollit të armëve të vogla, të lehta, municioneve dhe eksplozivëve, në përputhje me angazhimet e saj kombëtare dhe ndërkombëtare. Këto përparime janë reflektuar në disa drejtime kyçe që përbëjnë një bazë solide për rendin dhe sigurinë publike dhe për forcimin e shtetit ligjor.

Së pari është forcuar kuadri ligjor dhe nënligjor, përmes përafrimit me standardet e Bashkimit Evropian dhe instrumenteve ndërkombëtare dhe Protokollit të OKB-së për armët e zjarrit. Përmirësimet në kuadrin ligjor për armët e vogla dhe të lehta kanë krijuar një kornizë më efektive për parandalimin e keqpërdorimit dhe trafikimit të armëve, ku janë ndërmarrë hapa për të ndërtuar një sistem më të mirë të gjurmueshmërisë dhe regjistrimit të armëve, si dhe forcimit të mekanizmave të kontrollit në pikat kufitare.

Së dyti, kapacitetet e organeve shtetërore, agjencive të specializuara, institucioneve të pavarura, si dhe strukturat mbështetëse që kontribuojnë në hartimin, koordinimin, monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të strategjisë janë rritur në mënyrë të konsiderueshme, duke kontribuar në zhvillimin e mekanizmave të përbashkët bashkëpunimi lidhur me identifikimin, hetimin dhe goditjen e rrjeteve që merren me trafikimin e paligjshëm të armëve. Këto struktura kanë rritur aftësitë teknike dhe operative për të hetuar, analizuar dhe shkëmbyer informacione mbi aktivitetet kriminale të lidhura me armët. Përmes bashkëpunimit ndërinstitucional dhe koordinimit të aktiviteteve në kuadër të strategjisë është mundur një qasje gjithëpërfshirëse në adresimin e këtij fenomeni.

Së treti, vërehet një përmirësim i dukshëm në mbikëqyrjen dhe kontrollin e qarkullimit të armëve, si rezultat i forcimit të masave të sigurisë dhe zbatimit më të rreptë të ligjit. Një numër i konsiderueshëm armësh të paligjshme janë sekuestruar dhe asgjësuar gjatë viteve të fundit. Konkretisht, në vitin 2022 u asgjësuan 5509 copë AVL, ndërsa në vitin 2023 u shkatërruan 1017 copë AVL dhe rreth 411363 copë pjesë përbërëse të armëve.

Gjithashtu, bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar është intensifikuar përmes pjesëmarrjes në programe të përbashkëta me organizata si SEESAC, UNDP, UNODC, INTERPOL EMPACT- *European Multidisciplinary Platform Against Criminal Threats*, EUROPOL dhe partnerë bilateralë, duke mundur shkëmbimin e praktikave më të mira dhe koordinimin e operacioneve kundër trafikut ndërkufitar të armëve.

Në këtë kontekst, përpjekjet e Shqipërisë për të reduktuar qarkullimin e paligjshëm të armëve, për të forcuar kontrollin mbi to dhe masat e ndërmarra për kontrollin e tregtisë së ligjshme të armëve dhe municioneve përbëjnë një hap të rëndësishëm drejt përmbytjes së angazhimeve të saj si vend kandidat për në Bashkimin Evropian. Ato reflektojnë angazhim në nivel të politikave kombëtare për të adresuar në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme çështjet e sigurisë dhe sundimit të ligjit, në funksion të stabilitetit të brendshëm dhe bashkëpunimit rajonal, duke përfshirë transparencën përmes raporteve vjetore.

2.3 Mësimet

Siguria dhe kontrolli i armëve të zjarrit, eksplozivëve dhe lëndëve plasëse në Shqipëri përballet me sfida të shumta dhe komplekse, të cilat kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme dhe sistematike nga institucionet përgjegjëse.

Së pari, është e domosdoshme përmirësimi i përgjigjes institucionale ndaj keqpërdorimit të armëve të zjarrit, veçanërisht në rastet e dhunës në familje. Një tjetër sfidë e rëndësishme është trajtimi i lidhjeve të normave sociale/zakonore/kulturore që formësojnë qëndrimet e target grupeve të caktuara për përdorimin e armëve të zjarrit, me qëllim ndryshimin e sjelljeve shoqërore që mund të favorizojnë përdorimin e paligjshëm të armëve. Synohet rritje e pjesëmarrjes së grave në aspektet operacionale dhe teknike të kontrollit të armëve, si dhe përfshirje më aktive e organizatave të grave dhe shoqërisë civile në proceset e politikë-bërjes dhe vendimmarrjes.

Në fushën ligjore, mungesa e një kuadri të veçantë për kontrollin e prekursorëve të lëndëve plasëse përbën një boshllëk të rëndësishëm. Legjislacioni aktual trajton substancat kimike në mënyrë të përgjithshme, pa adresuar specifikisht kontrollin, monitorimin dhe kufizimin e materialeve që mund të përdoren për prodhimin e lëndëve eksplozive. Kjo situatë krijon rrezik për keqpërdorim dhe pengon ndërhyrjen efektive të institucioneve mbikëqyrëse. Po ashtu, mungesa e akteve nënligjore për zbatimin e ligjit nr. 74/2021, për përdorimin civil të lëndëve plasëse dhe piroteknikëve pengon krijimin e një sistemi të përshtatshëm për gjurmimin, identifikimin, autorizimin dhe kontrollin e magazinimit, transferimit dhe asgjësimit të këtyre lëndëve.

Në aspektin penal, procesi i rishikimit të Kodit Penal vazhdon ende, ku harmonizimi i dispozitave lidhur me armët e zjarrit me standardet ndërkombëtare, veçanërisht me Protokollin e OKB-së për armët e zjarrit, përbën një angazhim thelbësor.

Në nivel operacional, për ndërtimin e mekanizmave të qëndrueshëm për mbikëqyrjen dhe çaktivizimin e armëve të vogla dhe të lehta mbetet një sfidë e rëndësishme. Nevoja për forcimin e kapaciteteve institucionale, përmirësimin e bashkërendimit ndërinstitutional dhe sigurimin e burimeve të qëndrueshme për të parandaluar përhapjen dhe keqpërdorimin e këtyre armëve, ku theksohet domosdoshmëria e forcimit të kapaciteteve trajnuese në Institutin e Përgatitjes së Qenve Policorë për zbulimin e armëve të vogla dhe të lehta, në kabinetet e trajnimit dhe të akomodimit për punonjësit e policisë, të cilët do të trajnohen për shoqërues të qenve policorë. Gjithashtu, rritja e numrit të trajnimeve të specializuara për ndjekjen penale dhe aplikimin e masave penale ose kundërvajtjeve për keqpërdorimin dhe trafikimin e armëve mbetet nevojë edhe për periudhën vijuese, sidomos në lidhje me përdorimin e provave elektronike.

Në fushën e ndërgjegjësimit publik, mbetet i rëndësishëm sensibilizimi i subjekteve të licencuara, prodhuesve, dhe publikut të gjerë për rreziqet që sjell keqpërdorimi dhe përhapja e jashtëligjshme e armëve të zjarrit. Fokus i veçantë duhet t'i jepet edukimit të rinjve, ndërgjegjësimit mbi pasojat e gjuajtjes me armë gjatë festimeve, dhe luftës kundër dhunës me armë ndaj grave dhe në familje. Në këtë kontekst, rritja e partneritetit me median dhe forcimi i besimit të qytetarëve në institucionet e sigurisë janë elemente thelbësore.

Nga ana tjetër, sfidat teknike përfshijnë krijimin e një kuadri ligjor dhe mekanizmash praktikë për ndërmarrjen apo konsiderimin e një iniciative për legalizimin dhe dorëzimin vullnetar të armëve të zjarrit. Gjithashtu, përdorimi i qëndrueshëm i procesit të çaktivizimit të armëve dhe garantimi i mjediseve të sigurta për magazinimin e armëve dhe eksplozivëve në përputhje me standardet ndërkombëtare përbëjnë sfida kyçe. Këto kërkojnë investime në infrastrukturë, si dhe ngritjen e kapaciteteve të subjekteve juridike përkatëse, duke përfshirë prodhuesit, tregtuesit, poligonet, shoqëritë private të sigurisë dhe qendrat e trajnimit, për të vendosur sisteme efektive të inspektimit dhe kontrollit.

Në përmbledhje, sfidat në fushën e kontrollit të armëve të zjarrit, duke përfshirë edhe teknologjitë e reja, janë multidimensionale dhe kërkojnë një qasje të integruar, të koordinuar ndërinstitutionale dhe mbështetje të vazhdueshme në nivel politik, ligjor, operativ dhe shoqëror për të garantuar një menaxhim efektiv dhe të qëndrueshëm të armëve dhe eksplozivëve në vend.

3. Vizioni i Strategjisë

3.1 Vizioni

Brenda vitit 2030, Republika e Shqipërisë do të jetë një vend me një mjedis të sigurt dhe me kapacitete gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme në përputhje me standardet më të larta të sigurisë publike dhe angazhimet ndërkombëtare për të parandaluar, identifikuar, hetuar, ndjekur penalisht dhe ndëshkuar zotërimin e paligjshëm, trafikimin dhe keqpërdorimin e armëve të vogla dhe të lehta, municioneve dhe eksplozivëve, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe ato ndërkombëtare, duke kontribuar në forcimin e rendit dhe sigurisë publike, konsolidimin e sundimit të ligjit dhe garantimin e stabilitetit kombëtar dhe rajonal.

Hartimi i një dokumenti strategjik që parashikon objektiva për të siguruar një kontroll të plotë mbi armët e vogla dhe të lehta, municionet dhe eksplozivët, duke u bazuar në nevojat kombëtare, sfidat dhe situatën e kërcënimeve të reja të sigurisë në rajon dhe standardet e BE-së, OKB-së dhe OSBE-së për:

- Reduktimin e zotërimit dhe qarkullimit të paligjshëm të armëve;
- Fuqizimin e mekanizmave të kontrollit dhe monitorimit të veprimtarisë së lejuar me armë;
- Parandalimin përmes ndërgjegjësimit të publikut mbi rreziqet që lidhen me armëmbajtjen e paligjshme dhe keqpërdorimin në kontekstin e dhunës në familje ose dhunës me bazë gjinore;
- Parandalimin, zbulimin dhe goditjen e trafikimit dhe posedimit të paligjshëm të Armëve të Zjarrit, Pjesëve të tyre, Municioneve dhe Eksplozivëve;
- Parandalimin, kontrollin dhe reduktimin në mënyrë të qëndrueshme të armëve, municioneve dhe eksplozivëve jashtë kontrollit shtetëror përmes forcimit të kapaciteteve institucionale, legjislacionit, bashkëpunimit ndërinstitutional dhe ndërkombëtar, si dhe ndërgjegjësimit publik.

3.2 Treguesit e impaktit dhe treguesit e rezultatit

1. Niveli i harmonizimit ose i përputhshmërisë së kuadrit ligjor për kontrollin e armëve me kuadrin rregullator të Bashkimit Evropian, Traktatin për Tregtinë e Armëve dhe Protokollin e Kombeve të Bashkuara për Armët e Zjarrit;

2. Niveli i rritjes së koordinimit dhe efektivitetit të politikave në fushën e AVLME, përmes numrit të akteve shqyrtuara apo koordinuara nga Komisioni Kombëtar i AVL (projekte, memorandume, marrëveshje, raporte etj.) dhe numrit të takimeve të zhvilluara nga Komisioni Kombëtar i AVL-ve për koordinimin e politikave në këtë fushë.

3. Niveli i zbatimit nga organet e rendit, si dhe përgjigjja e shërbimeve të prokurorisë dhe gjyqësorit në lidhje me incidente/ngjarje që përfshijnë armë, municione dhe eksplozivë.

4. Numri i rasteve dhe sasia e armëve, municioneve dhe eksplozivëve të sekuestruara brenda territorit.

5. Numri i rasteve të raportuara dhe sasia e armëve, municioneve dhe eksplozivëve të sekuestruara në kufi.

6. Numri i licencave të eksportit nga të cilat armë dhe municione janë identifikuar si të devijuara përmes procedurës së kontrollit pas dërgesës.

7. Përqindja e konsolidimit të kapaciteteve njerëzore dhe logjistike të Njesisë Qendrore të Armëve të Zjarrit.

8. Niveli i bashkëpunimit operativ, referuar në përqindje në luftën kundër krimeve që lidhen me armët e zjarrit midis autoriteteve shqiptare dhe ato në rajon, Shtetet Anëtare të BE-së dhe agjencitë ndërkombëtare.

9. Numri i ngjarjeve dhe viktimave që përfshijnë armë dhe eksplozivë, të ndara sipas gjinisë dhe moshës.

10. Numri i armëve, municioneve dhe eksplozivëve të dorëzuara vullnetarisht, si dhe armëve të legalizuara apo të çaktivizuara.

11. Numri i armëve, municioneve dhe eksplozivëve të raportuara (të konfiskuara, të dorëzuara vullnetarisht ose tepricë) që janë shkatërruar sistematikisht.

12. Numri i armëve, municioneve dhe eksplozivëve në pronësi të: 1. Institucioneve; 2. subjekteve private juridike; dhe 3. civilëve, të raportuara si të humbura ose të vjedhura.

13. Niveli i përmirësimit sigurisë fizike të depove të ruajtjes/magazinimit të armatimit.

3.3 Metodologjia

Strategjia Kombëtare për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2025–2030 përbën një dokument strategjik të rëndësishëm që lidhet ngushtë me procesin e integritetit evropian të Shqipërisë dhe me angazhimin për të forcuar shtetin e së drejtës, sigurinë publike dhe stabilitetin rajonal. Ministria e Punëve të Brendshme, në rolin e institucionit lider për hartimin dhe monitorimin e politikave në fushën e rendit dhe sigurisë publike është përgjegjëse për mbarrëvajtjen e procesit të hartimit të dokumentit strategjik dhe anekseve shoqëruese si dhe koordinimit mes të gjithë institucioneve të tjera.

Ministri i Punëve të Brendshme miratoi urdhrin nr. 6, datë 14.1.2025, *“Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e strategjisë kombëtare për kontrollin e armëve të vogla e të lehta, municioneve dhe eksplozivëve 2025–2030 dhe planit të saj të veprimit 2025–2028”*. Grupi ndërinstitucional i punës u kryesua nga Zëvendësministri i Punëve të Brendshme përgjegjës për politikën dhe strategjitë në fushën e kontrollit të armëve të vogla e të lehta, municioneve dhe eksplozivëve dhe në përbërje kishte përfaqësues nga struktura përgjegjëse për politikën, buxhetin, programimin, standardizimin dhe harmonizimin e kuadrit rregullator në Ministrinë e Punëve të Brendshme, strukturat përgjegjëse në Policinë e Shtetit.

Në mbledhjet e grupit ndërinstitucional të punës u ftuan të marrin pjesë për të kontribuar në hartimin e dokumentit strategjik, në përputhje me funksionet dhe përgjegjësitë institucionale, anëtarët e Komisionit Kombëtar të Armëve të Vogla e të Lehta të krijuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 69 prot., datë 22.5.2017, *“Për ngritjen e Komisionit Kombëtar për Armët e Vogla dhe të Lehta (AVL)”* dhe përfaqësues nga institucione të tjera që ngarkohen për zbatimin e masave dhe aktiviteteve që parashikon kjo strategji.

Kjo strategji është hartuar në përputhje me metodologjinë e **Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030**, duke përfaqësuar parimet e qeverisjes së mirë, zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik e social dhe forcimit të institucioneve demokratike. Lidhja e saj me reformat në drejtësi, luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit është e drejtpërdrejtë dhe thelbësore për përmbushjen e kriterëve të kapitujve 1 “Lëvizja e lirë e mallrave”, 24 “Drejtësia, Liria dhe Siguria” dhe 31 “Politikat e Jashtme, të Sigurisë dhe Mbrojtjes”, të *acquis*-it të Bashkimit Evropian, veçanërisht në fushat që lidhen me kontrollin e armëve, mbikëqyrjen kufitare dhe ndalimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë.

Në përmbajtje, kjo strategji synon reduktimin e ndjeshëm të qarkullimit dhe posedimit të paligjshëm të armëve, municioneve dhe eksplozivëve në Shqipëri, përmes masave të integruara që përfshijnë përmirësimin e kuadrit ligjor, forcimin e bashkëpunimit institucional dhe ndërkombëtar, zhvillimin e kapaciteteve teknike e njerëzore dhe zbatimin e mekanizmave të monitorimit e raportimit. Strategjia orienton veprimet ndërinstitucionale për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga dokumente ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria, si Traktati për Tregtinë e Armëve, Protokolli i OKB-së për Armët e Zjarrit, Programi i Veprimit i OKB-së për Armët e Vogla dhe të Lehta, si dhe standardet e përcaktuara nga BE, OSBE dhe Udhërrëfyesi Rajonal për Kontrollin e Armëve të Vogla e të Lehta për Ballkanin Perëndimor për periudhën 2025–2030.

Në këtë mënyrë, Strategjia kontribuon drejtpërdrejt në zbatimin e **Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm, nr. 16** të Agjendës 2030 të OKB-së, duke synuar krijimin e një shoqërie paqësore, të drejtë dhe me institucione efektive. Më specifikisht, dokumenti është i lidhur ngushtë edhe me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara 5. 16.1, 16.4, 16.6, 16.a që synojnë:

- uljen e ndjeshme e të gjitha formave të dhunës dhe numrit të vdekjeve që lidhen me të;
- uljen e ndjeshme deri në vitin 2030, të flukseve të paligjshme financiare dhe të armëve, forcimin e rikuperimit dhe kthimit të aseteve kriminale dhe lufta ndaj të gjitha formave të krimit të organizuar;

- zhvillimin e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe transparente në të gjitha nivelet.
- forcimin e institucioneve përkatëse kombëtare, përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar, për ndërtimin e kapaciteteve në të gjitha nivelet, veçanërisht në vendet në zhvillim, për të parandaluar dhunën dhe për të luftuar terrorizmin dhe krimin.

Strategjia është konceptuar si një instrument i zbatueshëm, në përputhje me dokumentet ndërkombëtare si Traktati i Tregtisë së Armëve, Protokolli i OKB-së për Armët e Zjarrit, Programin e Veprimit dhe Instrumentit Ndërkombëtar të Gjurmimit të Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Çështjen e Çarmatimit, Dokumentin për Armët e Vogla dhe të Lehta e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Traktatin e Tregtisë së Armëve, Protokollin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara kundër Prodhimit të Paligjshëm dhe Trafikimit të Armëve të Vogla dhe të Lehta, si dhe Kodin e Sjelljes të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë mbi Aspektet Politiko-Ushtarake të Sigurisë. Në veçanti, ajo parashikon objektiva specifike që synojnë uljen e dhunës, reduktimin e flukseve të paligjshme të armëve dhe forcimin e kapaciteteve për parandalimin e krimeve dhe terrorizmit. Lidhja e saj me Programin e Qeverisë 2021–2025, kreu “Shqipëria e sigurt” është po ashtu e drejtpërdrejtë duke mbështetur ndërtimin e një Shqipërie të sigurt, ku qytetarët dhe investitorët ndihen të mbrojtur dhe besimi në institucionet publike rritet ndjeshëm.

Përmes një plani veprimi të detajuar që do të përfshijë objektiva të matshëm dhe tregues konkretë, kjo strategji do të mundësojë monitorimin dhe vlerësimin e progresit në nivel kombëtar dhe vendor. Zbatimi i saj do të kërkojë koordinim të ngushtë ndërinstitucional dhe mbështetje të vazhdueshme nga partnerët ndërkombëtarë duke garantuar përdorim efikas të burimeve dhe rezultate të prekshme në fushën e sigurisë. Në thelb, Strategjia Kombëtare për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2025–2030, përfaqëson angazhimin e Shqipërisë për të qenë një partner i besueshëm në promovimin e paqes, stabilitetit dhe sundimit të ligjit, si në nivel kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar.

Ajo ndërthur prioritetet kombëtare me angazhimet rajonale, përmes masave konkrete në kontrollin, gjurmueshmërinë dhe menaxhimin e armëve, si dhe bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar. Kjo përputhje garanton një qasje të qëndrueshme dhe të koordinuar, në përputhje me standardet e BE-së dhe qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Strategjia është hartuar sipas metodologjisë së formatit të sistemit informatik të planifikimit të integruar IPSIS miratuar me vendimin nr. 290, datë 11.4.2020, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar”, i ndryshuar, që përfaqëson standardin kombëtar për planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit në Shqipëri. Ky format siguron një strukturë të unifikuar, të harmonizuar dhe të integruar me kuadrin më të gjerë të planifikimit strategjik të shtetit shqiptar, duke mundësuar lidhjen vertikale dhe horizontale ndërmjet strategjive sektoriale dhe prioriteteve kombëtare, si dhe ndërmjet objektivave afatgjatë dhe masave konkrete të zbatimit. Përmes IPSIS, strategjia garanton transparencë dhe përafrim me buxhetimin afatmesëm, monitorim të rregullt të progresit përmes indikatorëve të matshëm dhe mekanizmave të raportimit të standardizuar dhe strukturën e planifikimit të nevojshme për përmbushjen e kërkesave të Bashkimit Evropian.

Hartimi i Strategjisë është planifikuar si pjesë përbërëse e Programit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2025, duke reflektuar angazhimin e Qeverisë së Shqipërisë për të adresuar në mënyrë të strukturuar dhe të koordinuar sfidat që lidhen me kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta, municioneve dhe eksplozivëve.

Gjatë procesit të hartimit të Strategjisë është ndjekur një qasje gjithëpërfshirëse, transparente dhe e bazuar në parimet e pjesëmarrjes demokratike sipas formatit dhe metodologjisë së IPSIS, e cila luan një rol kyç në mbështetjen teknike dhe koordinimin rajonal të Strategjisë Kombëtare për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe

Eksplozivëve të Shqipërisë. Kjo metodologji garanton hartimin dhe zbatimin e strategjive në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke siguruar që politika kombëtare të jetë e harmonizuar dhe e koordinuar me praktikën më të mira në rajon. Një element thelbësor i këtij procesi është **zhvillimi i konsultimit publik të strukturuar**, që ka përfshirë qytetarët, shoqërinë civile, grupet e interesit, organizatat e specializuara dhe institucionet publike që kanë rol në fushën e sigurisë, kontrollit të armëve dhe sundimit të ligjit ku mund të përmendim SEESAC, UNDP, UNODC dhe OSCE. Këto konsultime kanë ndihmuar në identifikimin e prioritetëve kombëtarë, në përmirësimin e draftit të strategjisë dhe në garantimin e një baze të gjerë konsensusi për masat e propozuara. Gjithashtu, procesi i konsultimit publik është zhvilluar në përputhje me **kornizën e transparencës dhe pjesëmarrjes së parashikuar nga legjislati shqiptar**, duke mundësuar komente, sugjerime dhe rekomandime nga publiku i gjerë dhe partnerët socialë nëpërmjet platformave elektronike dhe komunikimeve zyrtare. Kjo ka garantuar një **qasje të integruar dhe praktike në hartimin e strategjisë**, duke reflektuar realisht nevojat dhe sfidat aktuale.

Strategjia e re gjithashtu u hartua referuar gjetjeve të raporteve të monitorimit në zbatimin e Strategjisë për Kontrollin e Armëve të Vogla e të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2019–2024, të cilat tregojnë një progres të moderuar në përmbushjen e objektivave strategjikë, me theks të veçantë në përmirësimin e kuadrit ligjor, forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar, si dhe ndërgjegjësimin publik për rrezikun që paraqet posedimi i paligjshëm i armëve. Strategjia u hartua referuar edhe vlerësimit kombëtar të kërcënimit nga krimi i rëndë dhe i organizuar (SOCTA). Megjithatë, raportet evidentojnë nevojën për një qasje më të integruar në zbatim, përmirësim të kapaciteteve të mbledhjes dhe analizës së të dhënave, si dhe intensifikimin e masave parandaluese dhe operative ndaj trafikimit dhe shpërndarjes së armëve të paligjshme. Këto gjetje shërbejnë si bazë orientuese për hartimin e Strategjisë së re 2025–2030, duke synuar një qasje më të qëndrueshme, të matshme dhe të koordinuar me prioritetet e sigurisë kombëtare dhe standardet e Bashkimit Evropian.

3.4 Parimet e përgjithshme

Në funksion të ndërtimit të një qasjeje të integruar dhe të qëndrueshme ndaj kontrollit të armëve të vogla dhe të lehta dhe materialeve shpërthyes, Strategjia Kombëtare mbështetet në një sërë parimesh udhëheqëse, të cilat garantojnë legjitimitetin, efektivitetin dhe përputhshmërinë e saj me kuadrin kushtetues dhe ndërkombëtar. Struktura dhe përmbajtja e këtij dokumenti bazohen në këto parime:

Parimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë – Të gjitha masat dhe ndërhyrjet e parashikuara në kuadër të kësaj strategjie bazohen në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në legjislatin kombëtar në fuqi, si dhe në marrëveshjet ndërkombëtare dhe instrumentet ligjore të ratifikuara nga Shqipëria. Kjo garanton që zbatimi i politikave të kontrollit të AVL-ve dhe eksplozivëve të realizohet në përputhje të plotë me parimet e shtetit të së drejtës, legjitimitetin demokratik dhe angazhimet ndërkombëtare të vendit.

Parimi i sigurisë shtetërore – Kontrolli i AVL-ve, municioneve dhe eksplozivëve përbën një komponent strategjik të sigurisë kombëtare dhe të funksionimit të shtetit të së drejtës. Menaxhimi efektiv i këtyre elementeve mbështet ruajtjen e rendit publik, mbron tërësinë territoriale dhe forcon besimin e qytetarëve në institucionet e sigurisë. Ky parim afirmon se siguria e brendshme është një parakusht për zhvillim të qëndrueshëm, klimë të favorshme për investime dhe konsolidim të demokracisë.

Parimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut – Respektimi dhe promovimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut përbën një element të pandashëm të politikave të kontrollit të armëve. Masat e parashikuara synojnë të garantojnë mbrojtjen e të drejtave individuale, të dhënave personale dhe identitetit të çdo qytetari, pa diskriminim mbi bazën e gjinisë, moshës, etnisë, besimit fetar apo orientimit seksual. Fëmijët dhe të rinjtë gëzojnë

mbrojtje të veçantë në funksion të krijimit të një mjedisi të sigurt dhe të lirë nga rreziqet që lidhen me armatosjen e jashtëligjshme.

Parimi i përgjegjësisë – Strategjia njeh se suksesi i saj nuk mund të arrihet vetëm përmes ndërhyrjes së institucioneve shtetërore, por kërkon një angazhim të përbashkët të të gjithë aktorëve relevantë, përfshirë shoqërinë civile, sektorin privat, median, komunitetin akademik dhe publikun e gjerë. Ky parim thekson rëndësinë e ndarjes së përgjegjësisë në edukimin, parandalimin dhe ndërgjegjësimin mbi rreziqet që paraqet zotërimi dhe përdorimi i paligjshëm i armëve dhe eksplozivëve.

Parimi i gjithëpërfshirjes – Përballimi i rreziqeve që lidhen me AVL-të dhe materialet shpërthyes kërkon një qasje gjithëpërfshirëse që angazhon të gjitha nivelet e qeverisjes dhe aktorët ndërsektorialë. Strategjia nxit bashkërendimin ndërinstitucional dhe përfshirjen aktive të pushtetit vendor, institucioneve të arsimit, drejtësisë, shëndetësisë dhe shërbimeve sociale, për të garantuar një përgjigje të koordinuar dhe të qëndrueshme ndaj kërcënimeve të natyrës shumëdimensionale.

Parimi i bashkëpunimit ndërkombëtar – Në një kontekst të globalizuar të kërcënimeve të sigurisë, bashkëpunimi ndërkombëtar përbën një shtyllë kyçe për suksesin e strategjisë. Shqipëria mbetet e angazhuar për të bashkëpunuar me partnerët rajonalë, organizatat ndërkombëtare dhe nismat multilaterale në fushën e kontrollit të armëve, për të siguruar harmonizimin e standardeve, shkëmbimin e informacionit, ndërtimin e kapaciteteve dhe adresimin e përbashkët të sfidave që lidhen me trafikimin, qarkullimin e paligjshëm dhe keqpërdorimin e AVL-ve dhe eksplozivëve.

PJESA II

QËLLIMI I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË STRATEGJISË

QËLLIMI I POLITIKËS 1: Brenda vitit 2030, të garantohet miratimi i legjislacionit të harmonizuar për kontrollin e armëve, në përputhje me kuadrin rregullator të BE-së dhe detyrimet ndërkombëtare, si dhe standardizimi i tij në të gjithë territorin shqiptar.

Aktivitetet në kuadër të këtij qëllimi

Gjatë periudhës 2025–2030, synohet të plotësohet dhe të rishikohet rregullisht kuadri ligjor për kontrollin dhe menaxhimin e armëve, eksplozivëve dhe mallrave me përdorim të dyfishtë, duke garantuar përputhshmërinë dhe standardizimin e tij me kuadrin rregullator të Bashkimit Evropian dhe detyrimet ndërkombëtare. Ky proces do të përfshijë rregullimin e prodhimit, tregtimit dhe mbajtjes së armëve dhe eksplozivëve për përdorim civil, si dhe forcimin e masave për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të paligjshëm të armëve, eksplozivëve (duke përfshirë artikujt piroteknikë) dhe prekursorët e eksplozivëve. Gjithashtu, do të sigurohet zbatimi i standardeve më të larta të sigurisë dhe kontrollit për pajisjet ushtarake dhe mallrat me përdorim të dyfishtë, duke rritur bashkëpunimin me autoritetet ndërkombëtare dhe forcuar kapacitetet e institucioneve kombëtare për mbikëqyrjen dhe zbatimin e legjislacionit përkatës. Gjatë periudhës vijuese 2025–2030 do të synohet përafrimi i legjislacionit penal, legjislacioni për armët sinjalizuese dhe alarmuese, legjislacioni për eksportin e armëve të vogla e të lehta, si dhe ndryshimi i dispozitave përkatëse kur konsiderohet e nevojshme.

Objektivi specifik 1.1: Miratimi i kuadrit të plotë ligjor për të luftuar të gjitha format e keqpërdorimit, trafikimit dhe zotërimit të paligjshëm të armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve (AME) dhe harmonizimi me kuadrin ligjor të BE-së dhe OKB-së.

Objektivi specifik 1.2: Përafrimi me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira, me qëllim përmirësimin e reagimit të drejtësisë penale në fushën e kontrollit të armëve dhe në hetimet që lidhen me veprat penale me armë zjarri.

QËLLIMI I POLITIKËS 2: Brenda vitit 2030, të garantohen politika dhe praktika efektive për kontrollin e armëve në Shqipëri, të bazuara në analiza statistikore dhe të udhëhequra nga

informacionet e inteligjencës, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe detyrimet përkatëse.

Aktivitetet në kuadër të këtij qëllimi

Gjatë periudhës 2025–2030, synohet të zhvillohen dhe të harmonizohen strategjitë dhe planet e veprimit për kontrollin e armëve, dhe eksplozivëve në përputhje me Udhërrëfyesin e rishikuar Rajonal për kontrollin e armëve të vogla e të lehta për Ballkanin Perëndimor. Politikat e kontrollit të armëve do të integrojnë plotësisht çështjet e gjinisë dhe moshës, duke siguruar përfshirjen aktive të grave në proceset e vendimmarrjes dhe politikëbërjes. Një prioritet kyç do të jetë standardizimi dhe institucionalizimi i regjistrimit dhe grumbullimit të të dhënave mbi armët, dhe eksplozivët, të ndara sipas gjinisë dhe moshës, për të përmirësuar analizën dhe hartimin e politikave të bazuara në prova. Njëkohësisht do të forcohen funksionet e planifikimit, koordinimit dhe monitorimit të Komisioneve për AVL-të, për të garantuar politika efektive dhe të qëndrueshme. Një aspekt thelbësor do të jetë edhe gjurmimi i çdo arme të mbledhur ose të kapur, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar, për të parandaluar trafikimin dhe keqpërdorimin e tyre, si dhe nënshkrimit të marrëveshjeve dypalëshe ose rajonale në lidhje me shkëmbimin e informacionit balistik, sidomos me shtetet e Ballkanit Jugperëndimor, në kushtet kur është në përdorim i njëjti sistem, EVOFINDER. Gjithashtu do të kushtohet vëmendje dhe trajnimit specifik të punonjësve të policisë që merren me trajtimin e provave materiale balistike, që nga gjetja dhe deri tek ekzaminimi i tyre.

Objektivi specifik 2.1: Standardizimi dhe institucionalizimi i grumbullimit të të dhënave për armët e zjarrit sipas gjinisë dhe moshës, në lidhje me sekuestrimet e AVLME-ve të ligjshme dhe të paligjshme, incidentet e dhunshme me armë, provat balistike dhe të dhëna të tjera që lidhen me armët e zjarrit që çojnë në analizën rajonale periodike të rrezikut për AVLME dhe vlerësimin e kërcënimit.

Objektivi specifik 2.2: Rritja e nivelit të koordinimit dhe monitorimi i vazhdueshëm i strategjisë dhe planit të veprimit nga Komisioni Kombëtar i AVL për të garantuar politika efektive për parandalimin, zbutjen, reagimin dhe eliminimin e keqpërdorimit, trafikimit dhe përhapjes së paligjshme të armëve të zjarrit.

Objektivi specifik 2.3: Institucionalizimi i mbledhjes sistematike të të dhënave për drejtësinë penale dhe gjurmimit të AVLME-ve

Objektivi specifik 2.4: Integrimi i plotë i çështjeve gjinore dhe moshës në politikat për kontrollin e AVLME-ve duke garantuar pjesëmarrjen reale të grave në kontrollin e AVLME-ve.

Objektivi specifik 2.5: Rritja e parandalimit të keqpërdorimit të AVLME-ve.

QËLLIMI I POLITIKËS 3: Brenda vitit 2030, të reduktohet keqpërdorimi dhe prodhimi, zotërimi dhe qarkullimi i paligjshëm i armëve, municioneve dhe eksplozivëve përmes forcimit të kuadrit ligjor, rritjes së kapaciteteve institucionale dhe zbatimit efektiv të masave parandaluese dhe kontrolluese.

Aktivitetet në kuadër të këtij qëllimi

Gjatë periudhës 2025–2030, synohet forcimi i sistemit të analizës së rrezikut, kontrollit, monitorimit dhe parandalimit të devijimit të tregtisë së ligjshme të armëve, municioneve dhe eksplozivëve, përmes përmirësimit të kapaciteteve institucionale, procedurave dhe transparencës. Do të parashikohen dhe ndërmerren masa për parandalimin dhe luftimin e trafikimit, keqpërdorimit, prodhimit dhe mbajtjes së paligjshme të këtyre materialeve, duke forcuar pajisjet, procedurat dhe trajnimin e autoriteteve ligjzbatuese dhe subjekteve të drejtësisë penale. Një prioritet kyç do të jetë rritja e bashkëpunimit ndërinstitutional në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe forcimi i mekanizmave dhe platformave të bashkëpunimit bilateral dhe rajonal, duke garantuar ndarjen e inteligjencës dhe shkëmbimin sistematik të informacionit në kohën e duhur për të luftuar në mënyrë më efektive aktivitetet e paligjshme që lidhen me armët, municionet dhe eksplozivët.

Objektivi specifik 3.1: Garantimi i zbatimit të plotë dhe monitorimi i kuadrit ligjor, politik dhe procedural për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e armëve të vogla dhe të lehta, municioneve dhe eksplozivëve.

Objektivi specifik 3.2: Parandalimi i trafikimit (kontrabanda, tregtia dhe tranziti i paligjshëm) i AVLME-ve nëpërmjet proceseve dhe pajisjeve të përmirësuara dhe trajnimit të njësive të synuara ligjzbatuese.

Objektivi specifik 3.3: Forcimi i kontrollit, monitorimit dhe parandalimit të devijimit të tregtisë së ligjshme nëpërmjet përmirësimit të kapaciteteve, procedurave dhe transparencës.

QËLLIMI I POLITIKËS 4: Brenda vitit 2030, të reduktohet ndjeshëm oferta, kërkesa, zotërimi i paligjshëm dhe keqpërdorimi i armëve, municioneve dhe eksplozivëve përmes masave efektive parandaluese, forcimit të kornizës ligjore dhe bashkëpunimit ndërinstitucional.

Aktivitetet në kuadër të këtij qëllimi

Gjatë periudhës 2025–2030, synohet rritja e ndërgjegjësimit dhe përgjegjshmërisë së subjekteve të licencuara private dhe juridike, përfshirë prodhuesit, tregtarët, ndërmjetësit, koleksionuesit dhe shoqëritë e transportit, lidhur me rrezikun e keqpërdorimit, përhapjes së paligjshme dhe devijimit të armëve, municioneve dhe eksplozivëve. Në të njëjtën kohë, synohet forcimi i besimit të publikut tek institucionet e sigurisë dhe krijimi i partneriteteve të qëndrueshme për të rritur advokimin dhe informimin. Edukimi i popullsisë mbi rreziqet e armëve, me fokus të veçantë në parandalimin e dhunës ndaj grave, vajzave dhe dhunës me bazë gjinore, si dhe angazhimi i të rinjve në programe ndërgjegjëse janë masa thelbësore për reduktimin e keqpërdorimit të armëve. Po ashtu, fuqizimi i rolit të medias për raportim të përgjegjshëm dhe promovimi i legalizimit dhe dorëzimit vullnetar të armëve janë mjete të rëndësishme për reduktimin e zotërimit të paligjshëm dhe keqpërdorimit të tyre.

Objektivi specifik 4.1: Rritja e ndërgjegjësimit të subjekteve të licencuara private dhe juridike për rrezikun e keqpërdorimit dhe përhapjes së paligjshme të AVLME-ve, përfshirë rrezikun e devijimit për prodhuesit e AVLME-ve.

Objektivi specifik 4.2: Zhvillimi i partneriteteve të qëndrueshme me median dhe shoqërinë civile për promovimin e kontrollit, rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimin e publikut, për rrezikun e keqpërdorimit, mbajtjes së paligjshme dhe trafikimit të AVLME-ve.

Objektivi specifik 4.3: Rritja e kapaciteteve administrative dhe operacionale për sekuestrimin e armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve.

Objektivi Specifik 4.4: Përdorimi sistematik i çaktivizimit, dorëzimit vullnetar dhe/ose legalizimit si metoda për uljen e mbajtjes së paligjshëm të armëve të zjarrit.

QËLLIMI I POLITIKËS 5: Brenda vitit 2030, të reduktohet rreziku i përhapjes dhe devijimit të armëve, municioneve dhe eksplozivëve përmes forcimit të masave të mbrojtjes dhe sigurisë së stoqeve, si dhe zbatimit të proceseve efektive për asgjësimin e tyre.

Aktivitetet në kuadër të këtij qëllimi

Gjatë periudhës 2025–2030 synohet reduktimi sistematik i tepricave të armëve të vogla dhe të lehta municioneve dhe eksplozivëve përmes shkatërrimit të sigurt dhe mjedisor të qëndrueshëm, si dhe metodave të tjera efektive. Gjithashtu, synohet asgjësimi i rregullt, i sigurt dhe transparent i armëve, municioneve dhe eksplozivëve të konfiskuara ose të krijuara stok. Për të siguruar një menaxhim të përgjegjshëm dhe të qëndrueshëm, do të forcohen kapacitetet institucionale për menaxhimin e ciklit të jetës së AVLME dhe municioneve. Në këtë kuadër, do të garantohen mjedise të sigurta magazinimi, të përshtatura sipas nevojave të identifikuara dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Objektivi specifik 5.1: Shkatërrimi sistematik i stoqeve të tepërta të AME-ve në një mënyrë jo të dëmshme për mjedisin.

Objektivi specifik 5.2: Të kryhet shkatërrimi i AVLME-ve të konfiskuara në mënyrë periodike në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Objektivi specifik 5.3: Garantimi i mjediseve të sigurta të magazinimit për AVLME, të projektuara sipas nevojave të identifikuara dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Objektivi specifik 5.4: Ngritja e kapaciteteve të subjekteve juridike përkatëse (prodhues, dyqane riparimi, dyqane shitjeje me pakicë, tregtuesit, poligonet e qitjes, poligonet e gjuetisë, shoqëritë private të sigurisë, qendrat e trajnimit) për të përcaktuar sistemet e inspektimit.

PJESA III

PROJEKTET NË MBËSHTETJE TË ZBATIMIT TË STRATEGJISË

Projekti 1: Forcimi i masave të sigurisë në kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta në Shqipëri – Projekt vijues

Institucioni zbatues: SEESAC

Përfitues: Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë; Policia e Shtetit

Donator: Zyra për Heqjen e Armëve dhe Zbutjen e Pasojave, pranë Byrosë për Çështje Politikë-Ushtarake të Departamentit të Shtetit Amerikan (PM/WRA)

Kohëzgjatja e projektit: 20 shtator 2022–19 janar 2026

Vlera totale e financimit: 1,250,000 USD

Pezulluar nga donatori në vitin 2025

Ky projekt synon të forcojë masat e kontrollit të armëve të vogla dhe të lehta (AVL), përmes përmirësimit të sigurisë fizike, rritjes së përgjegjshmërisë dhe standardizimit të menaxhimit të stokut në depozitat nën administrimin e Policisë së Shtetit. Ndër ndërhyrjet kryesore përfshihet përdorimi i një sistemi të avancuar me barkod për administrimin dhe gjurmimin e armëve në depozitat qendrore në Mullet, si dhe përmirësimi i masave të sigurisë në trembëdhjetë ambiente prioritare të ruajtjes së provave dhe armëve në territorin e Republikës së Shqipërisë. Këto masa synojnë të adresojnë standardet ndërkombëtare për ruajtjen dhe kontrollin e armëve dhe municioneve. Zbatimi i projektit kontribuon drejtpërdrejt në përmirësimin e sigurisë kombëtare dhe rajonale, duke reduktuar rrezikun e përhapjes së pakontrolluar të armëve, shpërthimeve aksidentale dhe përdorimit të tyre në veprimtari kriminale. Brenda kornizës së Planit të Veprimit për AVL në Ballkanin Perëndimor, projekti adreson Objektivin Strategjik nr. 5 “Të reduktohet rreziku i përhapjes dhe devijimit të armëve, municioneve dhe eksplozivëve përmes forcimit të masave të mbrojtjes dhe sigurisë së stoqeve, si dhe zbatimit të proceseve efektive për asgjësimin e tyre”. Në përputhje me këtë, është synuar rritja e numrit të strukturave të ruajtjes të cilat i plotësojnë standardet ndërkombëtare të sigurisë.

Deri në tetor 2024, janë kryer vlerësime të detajuara teknike në shumicën e ambienteve të identifikuara për ndërhyrje, ndërkohë që janë zbatuar hapat për realizimin e përmirësimeve të sigurisë.

Gjithashtu është finalizuar zhvillimi dhe testimi i modulit të barkodit nga ekspertë IT të projektit në bashkëpunim me ekspertët e caktuar nga përfituesi. Trajnimi për operatorët e magazinës së Mulletit është kryer në nëntor 2024, ndërsa pajisjet teknologjike janë prokuruar në gusht 2024.

Pas përgatitjes së Termave të Referencës për angazhimin e një kompanie profesionale për hartimin dhe mbikëqyrjen e ndërhyrjeve të sigurisë në të gjitha lokacionet përkatëse, si dhe për zhvillimin e moduleve të reja të sistemit SIMA, me tenderimin e planifikuar për dhjetor 2024, financimi u ndërpre për shkak të pezullimit të financimit nga Departamenti Amerikan i Shtetit dhe do të vijojë përmes implementimit nga UNDP Albania.

Me Vendimin e Këshillit (CFSP) 2024/3006, të 2 dhjetorit 2024, në mbështetje të aktiviteteve të SEESAC për çarmatimin dhe kontrollin e armëve në Evropën Juglindore, duke zvogëluar kërcënimin e armëve të vogla dhe të lehta (AVL) të paligjshme dhe municioneve të tyre është miratuar edhe fondi prej 3999920,60 euro për përmbushjen e detyrimeve dhe

realizimin e politikave në fushën e kontrollit të armëve të vogla e të lehta në vendet e Ballkanit Perëndimor, Moldavisë dhe në mënyrë më të kufizuar për Ukrainën.

Mbështetja me këto fonde përfshirë Shqipërinë lidhet me këto komponentë:

Lehtësimi i bashkëpunimit rajonal dhe mbështetja për hartimin e politikave të bazuara në evidenca mbi kontrollin e AVL-ve, duke kontribuar kështu më tej në uljen e kërcënimit të përhapjes së paligjshme të AVL-ve.

Në mënyrë specifike, projekti parashikon lehtësimin e bashkëpunimit rajonal dhe mbështetjen e hartimit të politikave të bazuara në prova në kontrollin e AVL-ve përmes:

- takimeve rajonale të Komisioneve të AVL-ve (dy herë në vit), duke u përqendruar në shkëmbimin e informacionit dhe ndarjen e njohurive mbi politikat e kontrollit të armëve, si dhe standardizimin e tyre;

- takimeve rajonale të SEEFEN (një herë në vit) duke u përqendruar në shkëmbimin operacional të informacionit dhe bashkëpunimin ndërkufitar në luftën kundër trafikimit të paligjshëm të armëve të zjarrit;

- ofrimit të asistencës teknike dhe mbështetjes sipas kërkesës për Komisionet e AVL-ve dhe SEEFEN me qëllim përmirësimin e zhvillimit, hartimit, miratimit dhe zbatimit të politikave;

- mbështetjes sipas kërkesës për harmonizimin e legjislacionit për kontrollin e armëve për ndryshimet përkatëse në lidhje me legjislacionin e BE-së mbi kontrollin dhe standardizimin e armëve në të gjithë rajonin;

- mbështetjes për mbledhjen dhe analizën e të dhënave të AVL-ve;

- integrimin e perspektivës gjinore në hartimin e politikave për kontrollin e AVL-ve;

- mirëmbajtjes së platformave *online* të shkëmbimit të informacionit dhe përmirësimit të saj përmes zhvillimit të produkteve analitike sipas kërkesës, të rëndësishme për politikat në fushën e AVL.

Mbështetje e mëtejshme për ndërtimin e kapaciteteve të autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe atyre kufitare në parandalimin dhe luftimin e trafikimit të paligjshëm të armëve dhe eksplozivëve përmes:

- zhvillimit të Procedurave Standarde të Veprimit dhe ofrimit të trajnimit për menaxhimin kufitar në luftimin e trafikimit të paligjshëm të armëve në mbështetje të autoriteteve doganore në vendet e Ballkanit Perëndimor;

- ofrimit të pajisjeve dhe trajnimit për policinë kufitare dhe kriminale në luftimin e trafikimit të paligjshëm të armëve në mbështetje të autoriteteve të policisë kufitare dhe kriminale.

Përmirësimi i kapaciteteve për sigurinë fizike dhe menaxhimin e stokeve të armatimit përmes përmirësimeve të sigurisë së infrastrukturës, reduktimit të tepricave të stokut të armatimit dhe trajnimit të personelit që angazhohet në menaxhimin e tyre:

Aktivitetet kryesore të parashikuara janë:

- mbështetje për sigurinë e shtuar të dhomave të provave/magazinave të AVL-ve të policisë/autoritetit të brendshëm përmes përmirësimeve të infrastrukturës së tyre;

- mbështetje për shkatërrimin e AVL-ve të tepërta dhe/ose të konfiskuara;

- ofrim i mbështetjes për sistemet e menaxhimit të rezervave dhe inspektimit.

Projekti 2: Qasje Institucionale e integruar dhe forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar për kontrollin e AME (faza I)

Institucioni zbatues: UNDP Shqipëri

Periudha e zbatimit: 1 dhjetor 2023–30 nëntor 2025

Përfutjes: Policia e Shtetit Shqiptar

Donator: Fondi i Besuar me Shumë Partnerë (*Multi-Partner Trust Fund*)

Financimi total: 1,205,490 USD

Qëllimi i Projektit: Të ofrojë mbështetje dhe pajisje për Policinë Kufitare, Institutin e Policisë Shkencore dhe Njësinë e Hetimit të Vendit të Ngjarjes të Kukësit. Projekti synon gjithashtu të forcojë bashkëpunimin ndërkufitar dhe shkëmbimin policor ndërmjet Shqipërisë

dhe Kosovës në fushën e kontrollit të AVL-ve, përmes aktiviteteve të përbashkëta me UNDP Kosovë.

Objektiva dhe synime strategjike të Udhërrëfyesit Rajonal (Roadmap):

- Zbatimi i politikave të bazuara në të dhëna dhe inteligjencë;
- Reduktimi i qarkullimit të paligjshëm të armëve, municioneve dhe eksplozivëve;
- Rritja e numrit të sekuestreimeve dhe asgjësimeve;
- Rritja e ndërgjegjësimit për rreziqet nga armët dhe dhuna në bazë gjinore;
- Garantimi i ruajtjes së sigurt të armëve dhe municioneve.

Aktivitete të zbatuara deri në vitin 2024:

- Trajnime të përbashkëta me Kosovën për policimin komunitar, kontrollin e AVL-ve, eksplozivët dhe kornizat ligjore;
- Zhvillimi dhe validimi i kurrikulës kombëtare të trajnimit për AVL;
- Pajisja e Policisë Kufitare me mjete teknologjike (kamera termike, skanerë, etj.);
- Organizimi i fushatave ndërgjegjëse dhe ngritja e kapaciteteve të zyrave për media dhe informim publik;
- Vizita studimore në CEPOL dhe agjencitë forensike në Kroaci.
- Furnizimi me pajisje për patrullimet në kufirin e gjelbër;
- Pajisje hetimore të specializuara për AVL për Institutin e Policisë Shkencore Shqiptare.

